

Procesverbal

*Nga Mbledhja V (e pestë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:
28.05.2024*

Rend Dite

1. Miratimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
2. Miratimi i Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në seancën e pestë të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë! Para se ta qesim në votim rendin e ditës, dje keni pranuar një e-mail, ku i keni edhe dy propozime për dy pika të rendit të ditës. Fjala është për dy vendime të cilat i kemi miratuar në seancat e kaluara.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, i nderuar zv/kryesues i Kuvendit! Të nderuar asambleistë, përfaqësues të ekzekutivit dhe mjete të informimit! Më lejoni që, në cilësinë e kryetarit, të ju përshëndes dhe falënderoj për pjesëmarrje në këtë seancë! Në seancën e kaluar ne kemi marrë disa vendime të cilat, pas rishqyrtimit nga ana e organeve qendrore, na janë kthye: Vendimi për hartimin e PZhK-së 2024-2032 na është kthye në rishqyrtim. Në bazë të ligjit, të gjitha vendimet që na kthehen në rishqyrtim, ne jemi të obliguar si Asamble Komunale me i rishqyrtue ato. Siç e dini, pavarësisht pozitë apo opozitë, të gjithë jemi të interesuar që Komuna ta ketë Planin Zhvillimor Komunal në periudhën 2024-2032. Ne në vendimin e Asamblesë së fundit kemi bo disa lëshime, ku në bazë të vendimit që na ka pru Ministria, te Neni 1 – në vend se me e shkruie në vitin 2032, ne e kemi shkruie vitin 2031. Është bërë përlllogaritja gabim. Gjithashtu, te Neni 2 e kemi shënuar 8 vite, është dashtë me e shënuie së paku 8 vite. Kështu që ne këtë duhet ta përmirësojmë. Në Nenin 4, te emërtimi i zonave kadastrale, ne i kemi çue emërtimin e zonave kadastrale në bazë të Statutit të Komunës, që unë mendoj se e kemi pas mirë, mirëpo Ministria ka kërkuie që emërtimi të bëhet në bazë të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave. Mirëpo, në këtë ligj ka disa gabime, edhe gjuhësore: Krushevc është e shkruar në ligj, a duhet Krushevë; në vend se me u shkruie Orqushë, është e shkruar në ligj Orpushë; dhe në vend se me shkruie në ligj Brezne, shkruan Breense; në vend të Kukovc, duhet Kuk; Plajnik duhet Pllajnik; Rence duhet Rrenc; Shajn është në ligj, a duhet Shajne. Për këtë qëllim është kthye, ne duhet prapë ta bina Vendimin në bazë të asaj, edhe pse është me gabime, duhet ta bina Vendimin që ky PZhK të bëhet në bazë të Ligjit mbi Kufijtë Administrativë të Komunave. Kështu që, unë propozoj që për këtë qëllim, për mos me humb kohë edhe një herë, ne sot ta futim në rend të ditës dhe ta bëjmë plotësim-ndryshimin e këtij Vendimi. Të nderuar delegatë, ky vendim i ligjshmërisë na ka ardhë pasi që juve ju ka ardhë materiali. Kështu që, ne jemi detyruar dje me jua u çue. Edhe propozimi i dytë është, që në mbledhjen e kaluar ne kemi bërë propozim-vendimin për rishqyrtimin e Vendimit Nr.060/01-88519-5/24 për rialokimin e mjeteve të buxhetit nga viti 2023 në vitin 2024. Edhe pse ky vendim nga ana e Ministrisë na u kthye i ligjshëm, mirëpo Departamenti i Buxhetit nuk po e bën alokimin e mjeteve për ndërtimin e pllakës së kulmit në fshatin Bresanë, në vlerë të 21 mijë eurove, edhe asfaltimin e rrugës Dragash-Stadion në vlerën 27 mijë euro, Departamenti i Buxhetit po kërkon që këto mjete të shkojnë në Drejtoratin e Urbanizmit. Kështu që, ne i kemi çue në Drejtoratin e Urbanizmit, dhe të dy këto mjete me vlerë afër 50 mijë euro do t'i

çesim në investime kapitale në qytezën e Dragashit. Prandaj edhe një herë propozoj që edhe kjo pikë të hyjë në rend të ditës dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit. Edhe pse, thashë, Ministria e ka prurë këtë vendim të ligjshëm, Departamenti i Buxhetit nuk po lejon me e bo bartjen. Këto mjete duhet me i çue në Drejtoratin e Urbanizmit. Faleminderit!

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Si pikë e parë, kryesuese, na në mbledhjen e fundit kemi kërkuar që materiali me pikat e rendit të ditës me na u prurë fizikisht edhe e kemi votuar pro si Asamble, na ka mbështetur edhe drejtori i Administratës. Kjo çështje nuk është zbatuar nga ju si kryesuese, edhe nga drejtori që ka thënë se do t'ju shpërndajë me pikat e rendit të ditës. Unë nuk e di çka ka ndodhur, ju keni blerë printera edhe për shkollat, nëpër shkollat keni çuar me rreth 200-300 mijë, ku i keni bërë këto fotokopje unë nuk e di. Kurse tenderat kanë dalë me qenë fotokopje të reja, a kanë ardhur me 200-300 mijë fotokopje nëpër shkollat. A neve nuk po na bien në seancë pikat e rendit të ditës, që i kemi kërkuar veç me pikat e rendit të ditës, pa materialin shtesë. Te pika e dytë të kryetarit, që po thotë për hartimin e Planit, edhe për rishqyrtimin e alokimeve. Kryetar, që dy seanca rresht të kam thënë, po lidhem te Bresana zakonisht. Kur të thashë a mundën me u alokuar këto mjete diku tjetër, më ke thënë jo. Në seancën e tretë të marsit. Në seancën e tretë i ke pas te stadioni, në seancën e katërt i ke qit te kulmi. Unë me sa e di, kulmi u përfundua. Tash po thuesh, në seancën e pestë sot, po thuesh po i merr Drejtoriat e Urbanizmit. Pse me i marrë Drejtoriat e Urbanizmit, kur janë paret e një lokaliteti. Na kemi nevojë në lokalitet me i shpenzuar ato pare diku tjetër. Për këtë mënyrë, të kam thënë edhe në seancat e kalimeve, edhe sot po të them, ka me t'u kthyer prapë ky vendim në seancën tjetër. Kie me i zhagrit, qeto 21 mijë euro kie me i zhagrit seancë pas seance edhe kanë me t'u kthyer në fund prapë. Këto, qysh u planifikuar dhe në lokalitet me i shpenzuar këto pare, është mirë me i shpenzuar te qaj projekt të cilin e kemi bërë për ujërat atmosferikë – 21 mijë e 744 euro e diçka. Unë propozoj që mos me iu kthyer Drejtorisë së Urbanizmit 21 mijë euro të projektit të Bresanës, po qeto pare me u shfrytëzuar te ujërat atmosferikë qysh e kemi bërë në Bresanë. Faleminderit!

Zeni Krasniqi: I nderuar kryetar i Komunës, e nderuar kryesues, zv/kryesues, të nderuar asambleistë, ekzekutiv dhe ju të tjerë! Duke qenë se Vendimin të mëhershëm – ju e dini – për zhvillimin e procedurave në përzgjedhjen e drejtorëve i kaluar afati, kërkojmë nga Asambleja Komunale që në këtë pikë të rendit të ditës të votojë për vazhdimin e afatit të Komisionit të njëjtë, në mënyrë që të kemi bazë të mjaftueshme ligjore për zhvillimin e procedurave sa i përket zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe lajmërimit të përkohshëm. Ky propozim edhe kjo përzgjedhje bazohet në UA 151/2020, përkatësisht Pika 3 e Nenit 6, ku specifikohet se Komisioni Përzgjedhës për institucionet arsimore që janë në varësi të Komunës duhet të ketë këtë përbërje. Nëse ka nevojë, mandej unë ju tregoj se cila është përbërja e saj. Prandaj, kërkoj nga ju që t'i zgjatet afati Komisionit, që të shkurtohen procedurat. Faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Për rendin e ditës s'pata me shtuar diçka. Kemi folur disa herë për këto pikat që vijnë kështu, me parashutë. Po ndërlidhem te kërkesa e drejtorit për me e zgjat afatin. Po kallxon drejtori që ai Komisioni për të cilin na kemi thënë që është i paligjshëm, për përzgjedhjen e drejtorëve, drejtori i Arsimit ia vu kapakin edhe kallxoi që vërtet u konë i paligjshëm. Kështu që, kur skadon mandati i një komisioni, nuk i vazhdohet afati, po zgjidhet komision, drejtor. Kërkesën tënde është mirë me e plotësuar edhe me e ndryshuar. Domethënë, nëse ka skaduar afati, është mirë me e përzgjedhur një komision të ri. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje për të gjithë! Po më vjen mirë, drejtor i DKA-së, që sot qenke këtu edhe fillova me të parën, fjalimin e parë, po të përgëzoj që e ke marrë që të flasësh për arsimin. Pesë seanca radhazi kam kërkuar nga ju, drejtor, që të më jepni sqarime për këtë zhagritjen e anëtarëve të Komisionit.

Nuk ke pas guxim të dalësh këtu, derisa kur kam kërkue, mbrapa kamerave je dalë jashtë. Duhet ta kuptosh se kjo ka qenë e jashtëligjshme. E para, e dyta, edhe një gabim tjetër po e bëjmë nëse e bëjmë vazhdimin, që nuk vazhdohet. E treta, a ke njohuri që edhe drejtorët që i ke zgjedhë janë të jashtëligjshëm, por këtu nuk flasësh fare? Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, zonja kryetare, nuk e di nëse e dini se e përgatisni rendin e ditës për seancat e kuvendit komunal në bashkëpunim me kryetarin. Ne si delegatë mund të vijmë këtu dhe të paraqesim një propozim për ndryshimin e rendit të ditës. Drejtorët janë thjesht ndihmës të kryetarit të komunes dhe mund të vijnë këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve që ne i bëjmë, por nuk kanë të drejtë të propozojnë asgjë. Dhe ju kërkoi të respektoni ligjin dhe të respektoni rregulloren e këtij kuvendi, të mos fyeni dinjitetin e këtij kuvendi dhe mua si delegat.

Arijeta Skeraj: A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në miratim rendin e ditës, me tri propozimet. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro dhe 12 kundër, atëherë më lejohet që unë ta votoj edhe një herë këtë. Kalon rendi i ditës! Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i Statutit të QKMF-së.

Behar Brenoli: Selam alejkum, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, siç e morët në material, Ministria e Shëndetësisë viteve të fundit është duke punuar në unifikimin apo krijimin e një statuti të vetëm të të gjitha statuteve të qendrave të mjekësisë familjare në Kosovë. Për shkak se kishte mosmarrëveshje të ndryshme me ligjet, Ministria na solli një statut të unifikuar ose unik, i cili urdhëronte që ky status të votohet në kuvend. Edhe pse statuti i propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe ai aktual që kemi janë pothuajse identik, ata sërish na kërkuan që të kalojmë të gjitha procedurat ligjore në kuvend. Pavarësisht se Statuti është identik, na kërkuan që të kalojmë sërish në procedurë parlamentare. Pra, ju kërkujmë që më vonë të mos ketë probleme ligjore apo sanksione nga Ministria e Shëndetësisë, ta miratoni këtë statut. Faleminderit.

Shpetim Hajredini: E nderuar kryesuese, i nderuar ekzekutiv, të nderuar kolegë asambleistë! I nderuar drejtor, pata një pyetje direkte për ty. Qeky Statuti ku bazohet, e muj me e ditë unë? Zakonisht statutet, vendimet, të gjitha bazohen diku. Këtu s'kemi askund të shënuar në këtë material se ku bazohet ky statut. Shënimin se ku bazohet ky statut, përndryshe unë nuk mund të jam kundër këtij statuti, se është për të mirën e qytetarëve, por natyrisht që është dashtë të shënohet këtu se në cilin ligj, nen, ku bazohet. Besoj që po e kupton apo jo? Ju faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Ne si Grup Parlamentar do ta mbështesim këtë Statut, për arsye se ky Statut – si tha edhe drejtori – është i njëjti i vitit 2016, ku ishte i pushtetit të atëhershëm PDK-ja. Unë e kam një pyetje për drejtorin, masnej edhe për kryetarin. Pse deri më tash ky Statut është shkelë dhe a do të vazhdoni ta shkilni këtë Statut? z.Kryetar, unë prom të kam dëgjue shumë mirë, në debat kur ke qenë këtu, ke folë për QKMF-në e cila drejtorin e ka emëruë pa kandidaturë. Si mos të mundesh me e kthye kujtesën, e kam incizimin këtu. Ndërsa, ai drejtor ka qenë adekuat, ka qenë specialist i mjekësisë familjare, i ka pas të gjitha kushtet për me qenë drejtor i QKMF-së. Ndërsa, ju këtë Statut, masi është i njëjti, e keni shkelë Nenin numër 6, Nenin numër 11, Nenin numër 14, Nenin numër 17. Pasi të votohet ky Statut, a do ta shkilni prapë këtë Statut? Unë po due me ta marrë një shembull – pak është ndoshta qesharak, po në fund do ta kuptoni – këtu nuk është problemi i Statutit, këtu është problemi i udhëheqësisë. Drejtorin të cilin e keni sot, të cilin e kemi pas na – ta kam thonë edhe dje – problemi është sikur një pacient kur shkon te mjeku, thotë ku po e preki trupin po më dhemb, i bojnë incizime, analiza, kur e shohin në fund është gishti i thyer. Këtu Statuti është shumë i mirë, por gishtin e kие të thyer, kryetar. Drejtorin s'e ke adekuat për këtë punë. Drejtori, unë të kam thënë – mos kofsha në lëkurë tënde – një kryetar, një doktor 30 vjet përvojë pune, me pas një këshilltar një mësues

klasor, unë i kam thënë edhe kryetarit Shabanit, ai atëherë më ka thënë unë biology, s'un e kuptoj shumë shëndetësinë, veç një specialist ta ketë këshilltar një mësues klasor, ta kam thënë edhe dje, po ta them edhe sot, ta kam dhënë edhe një propozim dje në Komitet, me drejtorin e Urbanizmit është mirë me e bo njëfarë rrokade, ai me ardhë drejtor i Shëndetësisë, bare i kupton ligjin, e ky zotnia me shkue në Urbanizëm, sepse çdo foto, çdo video, çdo tender e kie nëpër Facebook-a publik. Edhe, po më vjen çudi mu – qe, për shembull, ku bëhet ndërtimi i rrugëve, drejtorin e kie. Jo jo, po qaty jemi, edhe në eventuale shkojmë. Qe edhe këtu ku e kie, ky drejtor krejt sendet i bën, përveç drejtor i Shëndetësisë. Për atë Shëndetësia është në kolaps. Po të them edhe një herë, ndërroja vendin e punës, se është marakli i tenderave, ju e dini shumë mirë, është marakli i kubëzimeve, është marakli i kanalizimeve, është marakli edhe i mbeturinave me i mbledhë. Po kam qef që, për të mirën e qytetarëve, për të mirën e pushtetit, me e bo njëfarë rrokade.

Arijeta Skeraj: Atëherë, Artan, të kisha lut vetëm rreth Statutit!

Artan Loshaj: Po pse, a s'jam t'u folë për Statutin? E ka shkelë ligjin kryetari. Nenin numër 6, Pika 6 thotë këtu: Nuk do të ketë përveç mjekut familjar, pediatri dhe gjinekologut nuk do të ketë mjekë tjerë. Ju e keni shkelë ligjin numër 6, Pika e 6-shtë, ku thotë – znj.Arijetë, të kërkoj falje unë, se nuk ta prishi, a bën një troh me më prit – veprimtaria, për mos me shkue shumë larg, në QKMF-në e Dragashit nuk lejohet të bëhet pranimi i specialistëve nga lëmitë e tjera. Ndërsa në QKMF punon oftamologu, edhe atë pensionera, punon neuropsikiatri edhe punon internisti. Shkojmë më poshtë, Neni numër 11 – se lloptopin, dje kam lyp kushte, po s'më ke ofrue kushte me folë, po duhet prapë në telefon me m'prit pak – Neni numër 11... po për Statut jemi t'u folë. Kryetar ku je, po e drejtë e jemja është me dalë, kryetar. Ti a tash po na përzihesh, lë gji drejtorat, qetash edhe ti ja nise këtu. Unë qekaë di edhe qytetarët më kanë çue... kërkoj falje, dal edhe një herë. Tash, a të kam ty shef unë, a kryetarin? Unë rreth Statutit jam t'u folë.

Arijeta Skeraj: Artan, ti mundesh me vazhdue rreth Statutit! Kërkush nuk ta ndërpret, kur ta ndërpres unë, atëherë shkojsh. Kryetari prej atje nuk guxon ty me ta ndërpre! Vazhdo!

Artan Loshaj: Mirë, faleminderit shumë! Këshilli Drejtues, struktura, domethënë këtu Këshilli Drejtues duhet me i pas pesë anëtarë: Drejtorin, udhëheqësin e Departamentit, Kryeinfermieren. Udhëheqës të Departamentit nuk ka. Shkojmë Neni 17, Trupat e QKMF-së, asnjë s'e ka, unë po pres prej kryetarit, do të ia votojmë, se është i PDK-së ky, ky është i joni, na që e kemi pru edhe prapë duhet me e mbështet na, se është shumë i mirë, na këtë nuk e diskutojmë. Se kryetari të nxit me bo debate edhe pse nuk kam qef disa sende me hi, po qe. Trupat e QKMF-së, Këshilli Profesional, Këshilli Disiplinor, Këshillin e Ankesave, Këshillin për Cilësi edhe Komisioni Etik-Shëndetësor, qe tri vite udhëheq kryetari me këtë drejtorin që e ka, asnjë komision nuk e ka. Unë po e votoj për të mirën e qytetarëve edhe po pres që këto komisionet me u votue. Po himë edhe te Neni 14 për votimin dhe shkarkimin e drejtorit. Drejtori duhet me qenë – po pres me u bo – procedura për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit: Drejtorin e zgjedh Drejoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Social, të cilën nuk e ka bo ky drejtor i kockave dhe i kubëzimeve. Drejtor i QKMF-së duhet të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, të jetë mjek specialist nga mjekësia familjare, përparësi kanë kandidatët me pesë vjet përvojë pune, s'po hyjmë këtu. Unë edhe një herë do të dal masi të votohet, t'i tregoj kryetarit edhe këtij drejtorit që e kanë gabim edhe që duhet me u përmirësue, se shëndetësia është në kolaps e sipër.

Munir Jonuzi: Pershendetje te gjithëve. Dëshiroj të shfrytëzoj rastin për të uruar 25 vjetorin e misionit të OSBE-se në Kosovë. Unë do të flas vetëm për këtë statut dhe disa nga qëndrimet e mia për këtë statut. Unë nuk do të shkoj përtej fushëveprimit të këtij Statuti që kemi përpara. Drejtori i

Shëndetësisë ka të drejtë dhe dje zoti Kryetar tha se ky status nuk ndryshon shumë nga ai i mëparshmi. Se ka një shabllon të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë në formën e një udhëzimi administrativ, ku i takon drejtorisë komunale të shëndetësisë të ndryshojë disa gjëra dhe t'i përshtatë ato me nevojat e komunës së tyre. Ato pak gjëra i referohen disa ndryshimeve, vendosjes së emrit të komunës dhe harmonizimit të atij statuti me rregulloret ligjore që janë në fuqi. Edhe pse ne kemi pothuajse çdo gjë të bërë në formën e një shablloni, përsëri duhet të rregullojmë disa gjëra. Aq sa e lavdërova dje për planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, në komisionin për politikë dhe financa, i cili vërtet bëri një plan të mirë veprimi dhe më vjen mirë që një plan i tillë erdhi nga drejtorja e arsimit. gjë që tregoi se ata kanë një administratë të aftë dhe se mund të shkruajnë një dokument që do të jetë në një nivel të lakmueshëm. Megjithatë, nuk mund të them të njëjtat lëvdata për Drejtorinë e Shëndetësisë. E kam fjalën në mënyrë strikte për administratën shëndetësore dhe jo për punonjësit e shëndetësisë. Nuk mund t'i lavdëroj të gjithë drejtorët komunalë, si dhe të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve që morën pjesë në bordin e pestë të këtij viti, i cili u mbajt në fillim të majit të këtij muaji, në fillim të këtij muaji. Thjesht, zoti President, në bazë të këtij statuti, lind pyetja nëse bashkëpunëtorët tuaj, qofshin drejtorët tuaj, duan t'ju ndihmojnë të menaxhoni dhe t'ju prezantojnë në mënyrën më të mirë, apo e kundërta. Në bazë të këtij Statuti mendoj se është e kundërta. Unë do ta them tani dhe do ta vërtetoj, pavarësisht se dy-tri gjëra që janë të një rëndësie vendimtare është dashur të ndryshohen dhe të përshtaten për nevojat e kësaj komune, por kjo nuk u bë, vetë drejtori i shëndetësisë dhe ekipi që. të dalë nga ky statut kanë treguar mendjelehtësi në punën e dikujt. Fillimisht do të përpiqem të filloj me disa gjëra më të lehta, është termi kujdesi shëndetësor primar ose shkurtesa kshp, e cila dominon në versionin në gjuhën boshnjake, megjithatë dallon dukshëm nga kujdesi shëndetësor primar ose shkurtesa pzz, e cila dominon në udhëzimet administrative. Për të hartuar një statut të tillë duhet të ndryshojmë dhe të rregullojmë kushtet me udhëzimin administrativ. Më duket se si versioni në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë anglisht e përdorin këtë term, unë sugjeroj ndryshimin e kujdesit shëndetësor parësor në kujdesin shëndetësor parësor. Ky është propozimi i parë, neni 6, paragrafi 6, duhet ta heqim këtë paragraf nga ky statut, sepse mendoj se nuk është më i nevojshëm. Një anëtar i tillë ishte i domosdoshëm kur QKMF po riorganizohej dhe që specialistët e ORL të mos mbeten pa punë. Kur u miratua statuti i mëparshëm, ne kishim një otolarinolog, i cili i kryente aktivitetet e tij në qendrën kryesore të mjekësisë familjare, por meqenëse periudha tetëvjeçare është jashtëzakonisht e gjatë dhe mjekët që i kryenin këto shërbime në spital, shkonin te pensionin e merituar, besoj se ky nen duhet të hiqet ose të rregullohet me udhëzim administrativ nga viti 2020, i cili thotë se ekspertët të fushave të tjera mund të vazhdojnë punën në kujdesin parësor shëndetësor si konsulentë mjekësorë deri në pension. Pyeta shumë nëse kemi një ORL në qendrën tonë kryesore familjare dhe të gjithë përveç njërit më thanë se nuk kemi. Ky i fundit doli në pension në 2019. Më duket dhe prandaj kërkoj dhe propozoj, ose të hiqet ky nen ose të shtohet ashtu siç është në udhëzimet administrative. Më tej, neni shtatë paragrafi 1.7 ku QKMF ofron shërbime të planifikimit familjar, çfarë lloj shërbimesh të planifikimit familjar mund të ofrohen nga punonjësit e QKMF. Kjo më kujtoi paraqitjen e një zyrtari të lartë të një shteti fqinj në një emision në gjuhën serbe nga Kosova, i cili thotë, kemi informacione se vitin e ardhshëm do të kemi një numër më të madh të foshnjave të sapolindura, një gazetare, një inteligjente. , njeri mendjempërtë, e pyet nga e di ti këtë. Si e dini ju që vitin e ardhshëm do të kemi një numër më të madh të foshnjave të porsalindura dhe ky zyrtar kur e kuptoi se për çfarë bëhej fjalë filloi të qeshte në mënyrë të pakontrolluar. Disa nga delegatët që morën pjesë në hartimin e këtij statuti në mandatin e kaluar do të thonë se në statutin e mëparshëm ishte shkruar për shërbime të planifikimit familjar ose

jo, mund të na pëlqejë ndonjë ligj ose jo, si ndonjë udhëzim administrativ, por ajo që është e rëndësishme është që ne duhet ta respektojmë atë. Udhëzimi administrativ gjatë këtyre periudhave nga viti 2016 deri në vitin 2024 ka hasur në një sërë ndryshimesh. Një ministër i Shëndetësisë në një nga qeveritë erdhi në tetë vitet e fundit me ekipin e tij dhe filloi të lexonte këtë udhëzim administrativ dhe kur hasi në këtë artikull ai e ndryshoi menjëherë. Ai nuk ndryshoi shumë gjëra, nuk ndryshoi pothuajse asgjë, përveç dy-tre gjërave. Një nga ato dy ose tre gjëra ishte se ai futi shërbimet e shëndetit riprodhues këtu në paragrafin 1.7. E cila është një fjali shumë më logjike dhe dukshëm e ndryshme nga ajo e mëparshme në kuptimin e saj. Dhe që nuk përfaqëson marrëzi të rënda dhe që nuk është e paqartë. Askush nuk pret që ne të shpikim ujin e nxehtë, vetëm për të ndjekur udhëzimet e vlefshme administrative. Pra, propozimi im i radhës është që në vend të shërbimeve të planifikimit familjar, të vendosim shërbime të shëndetit riprodhues, siç është në udhëzimet administrative. Më lejoni t'ju tërheq vëmendjen për versionin në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë, kemi shumë gabime teknike, ku disa fjalë janë të bashkuara dhe të palexueshme. Vazhdojme paraardhësi im foli për nenin 14 dhe thote e ka anashkaluar një, procedurën e emerimit dhe shkarkimit të drejtorit të QKMF, në pikën e parë thuhet se drejtori i QKMF -it zgjidhet në përputhje me ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, me numër 03/L-149, dhe këtu kam filluar të mërzitem. Mbi injorancën, mbi mendjehetësinë, për ngatërresën e drejtorit tonë shëndetësor. Unë e kontrollova këtë ligj tre herë dhe mora të njëjtin rezultat të tri herë. Ky ligj është shfuqizuar. Ndoshta zoti President keni marrë kërkesa nga Ministria e Shëndetësisë për ndryshimin e statutit. Por një nga arsyt kryesore ishte pikërisht ky ligj. Të gjithë e dimë se në dhjetor 2022, ky ligj u zëvendësua me ligjin për nëpunësit publikë, i shpallur me dekret të presidentes sonë, zonjës Vjosa Osmani, në shtator të vitit 2023, nesër ose pasnesër do të hyjmë në procedurë për zgjedhja e drejtorit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare me ligj që nuk është më në fuqi. Dhe nëse e dërgojmë diçka të tillë, nëse e dërgojmë në Prishtinë, atje ka njerëz që pyesin se çfarë delegate kemi dhe çfarë drejtori shëndetësor kemi dhe çfarë administrate është kjo. Kur nuk zbatuam as ligjin më elementar dhe gjërat më elementare për të cilat duhej ta ndryshonim këtë statut. Së fundi, edhe një propozim, Bazuar në nenin 21 paragrafi 6 i udhëzimit administrativ të vitit 2020, i cili thotë se çkmf me staf prej më shumë se 100 punëtorësh ka edhe një zëvendësdrejtor, komuna jonë i përket asaj kategorie, të paktën i takonte. kjo liste nuk e di se çfarë do të jone rezultati dhe listat, prandaj sugjeroj që ta fusim në nenin e statutit President, ju flisni me avokatet tuaj dhe shikoni se cili vend është me i pershtatshëm. cili është vendi më i pershtatshëm për të futur këtë artikull. Nuk ka rëndësi nëse do të jetë nën zgjedhjen e drejtorit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare apo nëse do të formoni një anëtar të ri. Ajo që dua të them është, le të vendosim dy anëtarë, se zëvendësdrejtori do të ketë të njëjtin autoritet me drejtorin në rast të mungesës së tij, se zëvendësdrejtori do të zgjidhet nga drejtorja e shëndetësisë dhe një tjetër si zëvendësdrejtor. , zëvendësdrejtori do të jetë nga komuniteti joshumicë nëse drejtor nga komuniteti shumicë dhe anasjelltas. Unë do ta mbështes këtë statut, sigurisht me gjithë këto ndryshime që kam përmendur. Unë ju falënderoj.

Nedžmidin Sejdlar: E kam dëgjuar me vëmendje kolegun Jonuzi dhe i mbështes propozimet e tij, vetëm se propozimi i fundit do të ndryshojë, zëvendësdrejtori do të jetë nga grupi më i madh i komuniteteve joshumicë. Pra, ne duhet të dimë se kush është ku. Faleminderit.

Jetmir Ajdini: Përhëndetje për të gjithë! Atëherë, një pyetje kisha për drejtorin e Shëndetësisë, i cili është prezent këtu. Kisha pas dëshirë me na e spjegue drejtori edhe me na dhënë spjegim, ku dallon Statuti i kaluar nga ky që sot e kemi për miratim? Në cilat pika është dallimi i Statutit të kaluar me këtë Statut. E dyta, a do t'i përmbaheni këtij Statuti që do ta votojmë sot, në të gjitha pikat e tij? Drejtori

nuk po ngon, pyetjet janë për drejtorin. A do t'i përmbaheni këtij Statutit të cilin do ta votojmë sot, me të gjitha pikat e tij, prej përzgjedhjes së drejtorit, e të gjitha pikat që ceken në këtë Statut. E para, me dalë me ne spjegue ku dallon Statuti i kaluar nga ky Statut që do ta votojmë sot. A është më i mirë se i kalumi edhe ku i kemi bo përmirësimet. Edhe, çka do të ofroni risi në këtë Statut. Faleminderit!

Agron Gashi: Ju përshëndes, të pranishëm! Përshëndetje kryetar, kryesuese dhe gjithë kolegët e tjerë! Unë përbrenda këtij Statuti vetëm pak kisha një pyetje. Përmes medimeve televizive nga ana e Shqipërisë pashë që Komuna e Dragashit trajton edhe pacientë nga Shqipëria, nga Shishtavec, Borja dhe fshatra të tjerë të cilat nuk i di. Në kuadër të këtij tretmani të pacientëve jashtë kufirit, është mirë të ceket a është numri i madh i tyre. A keni ndonjë memorandum bashkëpunimi me qendrën e tyre të Kukësit, shëndetësinë, QKMF-në e Kukësit. Tjetër, unë si qytetar i kësaj Komune, po ika deri në QKMF të Prizrenit, patjetër duhet të kem edhe një udhëzim. Ai udhëzim të paktën është një participim prej 10 euro dhe vajtja-ardhja jashtë kufijve në brendi të Kosovës, a duhet të kenë udhëzim ata, a paguajnë ata, a participojnë brenda mjekimit që bëni ju. Në anën tjetër, desha një dy fjalë miradije të flas lidhur me QKMF-në e Dragashit, sepse është bërë një renovim i brendshëm i saj, një infrastrukturë bukur shumë e pëlqyeshme. Por, megjithatë, edhe duke u mjekuar disa herë në këtë QKMF këtu, ka gjetur trajtim të mirëfilltë, falë gjithë atyre mjekëve dhe motrave medicinale që kryejnë punën aty. Dhe po ta krahasosh me Prizrenin, është për një lëvdatë, sepse i gjithë stafi është në gatishmëri dhe gjejnë tretmanin e duhur. Faleminderit!

Behar Brenoli: Selam, sa i përket pyetjes, nuk e di sa më keni kuptuar kur thashë se ky statut është bërë nga Ministria e Shëndetësisë. Ju pyetët për ligjshmërinë, e kanë bërë në bazë të ligjit për shëndetësi, ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe ligjeve të tjera në fuqi. Këtë e kanë bërë avokatët e Ministrisë së Shëndetësisë, ky statut nuk është punuar në Drejtorinë e Shëndetësisë. Ne nuk e kemi ndryshuar këtë statut, ndryshimi i vetëm është, pasi Jetmiri ka kërkuar që të mos kenë maternitete të gjitha komunat në Kosovë, prandaj shtuam se kemi edhe maternitet. Nuk ka ndryshime të tjera, prandaj thashë që statuti është identik me atë që kemi pasur më parë. Akuzat se drejtorja e shëndetësisë dhe administratës ka bërë disa ndryshime, se jemi të paaftë, nuk vlejnë, sepse ne nuk e kemi krijuar këtë statut. Sa i përket specialistëve, ne kemi vetëm këta specialistë që janë sipas statutit, të cilët janë të punësuar në qendrën shëndetësore dhe në objektet tona të tjera shëndetësore. Fakti që kemi marrë specialistë të tjerë është diçka tjetër, e kemi diskutuar dy vite më parë, kështu që na dërguan inspektoratin e Ministrisë së Shëndetësisë, kështu që u përpoqën të na bllokojnë shërbimet shëndetësore, në fund të fundit, ata punojnë edhe sot. sepse të gjitha në përputhje me ligjet dhe në përputhje me nevojat që kemi këtu. Nëse dikujt nuk i pëlqen ajo politikë shëndetësore, e drejton kryetari me drejtorin dhe bashkëpunëtorët e tjerë, është e tyre. Kemi vlerësuar se kemi nevojë për këta specialistë dhe i kemi punësuar. Ata nuk janë punonjësit tanë, ndaj ne nuk po e shkelim këtë statut. Sa i përket intervenimit brenda këtij statuti, ne jemi udhëzuar rreptësisht nga Ministria e Shëndetësisë që të mos bëjmë asnjë ndryshim, sepse ky statut është unik për të gjithë Kosovën. Pra, nëse e ndërrojmë ne në Dragash, do ta ndryshojnë edhe komunat tjera, dhe atëherë nuk do të jetë unike për tërë territorin e Kosovës. Dhe sa i përket ORL-se nuk kam pare asnje planifikim shërbimi e te ngjashme ketu, normalisht ka edhe qendra keshillimore, nuk e di çfare e ka shqetësuar paraardhësin. Ne kete version qe kam une askund nuk shkruan ORL apo dicka te tille.

Driton Ademi: Kisha pas qef drejtorin me e pyet, parëz, në fjalimin e parë tha ka ndryshim. Tash tha nuk po na lë ndryshim Ministria. Ku je duke u bazue, se s'jam t'u kuptue, del ma qarte te cila pikë po dalish, a ka ndryshim, a s'ka ndryshim? Me sa unë e kam lexue, prej vitit 2016 me këtë që e keni pru sot, thuaja se gati është i njëjtë. S'di a ka ndryshim, shumë pak ka ndryshim. Artani ta përmendi një

shembull të mirë me gishtin, a kie me bo ndryshim ti që e ke motrën kryesore e kie qe dy vjet me ushtrues detyre? Ti po e bësh ndryshimin e Statutit, po a kie me e ndryshue edhe motrën kryesore që e kie qe dy vjet me ushtrues detyre? Plus drejtorin, që e kie qe gjashtë muaj, ndoshta ma shumë, me ushtrues detyre. Sa ka mandat ushtruesi i detyrës me e mbajt, a gjashtë muaj, unë me sa e di gjashtë plus gjashtë është. Tip o duesh me bo ndryshim, po me të njëjtët persona që ke me vazhdue hala. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Drejtor, nëse ne e miratojmë këtë Statut, a do të thotë që specialistët të cilët i keni angazhue me punë shtesë, qe dy vite, a do të thotë se duhet t'u ndërpritet kontrata e punës atyre specialistëve. Nëse ne e miratojmë këtë Statut, që është, Statuti miratohet në bazë të Ligjit për Shëndetësi të cilin e sjell Ministria e Shëndetësisë. Në Statut ceket qartë se cilat lëmi lejohet të punojnë në QKMF. Përveç atyre, ne e dimë që doktori i ka ftue edhe punojnë specialisti i internos, specialisti i oftamologjisë edhe neuropsikiatri. A do të thotë që në bazë të këtij Statuti, ne duhet t'ua ndërpresim kontratën atyre? Atëherë jemi kundër ligjit edhe kundër Statutit. Të lutem, një përgjigje!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, ne sot në rend të ditës e kemi miratimin e Statutit. Ministria ka punue në atë drejtim që të gjitha statutet e QKMF-ve në nivel të Kosovës të jenë të njëjtë, për arsye se ligji është i njëjtë. Ka bërë lëshime vetëm për disa komuna. Njëra prej tyre është edhe Komuna jonë. Komunitat të cilat kanë pas në gjirin e vet lindore, dhe e kanë pas gjinekologun edhe pediatrin, neve na ka lejue që në Statut ta lëmë, mos ta hekim. Do të thotë, ky Statut është i njëjtë, ne nuk e kemi hek atë. Është edhe gjinekologu, është edhe lindorja, është edhe pediatri. Ne e falënderojmë Ministrinë që na e ka mundësue. Tash është punë e juaja, po ky Statut duhet të miratohet në këtë formë, për arsye se këtë Statut e ka përgatit Ministria edhe ky i ka kalue të gjitha procedurat, ka qenë edhe në debat publik. Sa i përket mjekëve specialistë, të cilët i kemi angazhue na dhe janë duke punuar në QKMF, ata nuk kanë kontratë me QKMF-në. Ata do të vazhdojnë të punojnë derisa Komuna të marrë ndonjë vendim tjetër. Këta janë të marrur më thirrje publike dhe nuk e kemi vetëm ne këtë, e kanë shumë komuna. E ka edhe Mamusha, angazhojnë mjekë shtesë. Po kjo s'ka lidhje me Statutin e QKMF-së. Ata do të vazhdojnë të punojnë, nëse na bëjmë vitin e ardhshëm prapë thirrje publike, ne mund të angazhojmë edhe specialistë tjerë, e jo vetëm këta tre. Faleminderit!

Artan Loshaj: z.Kryetar, kjo nuk është risi që po thuesh na kanë lejue, se këtë na kanë lejue neve në vitin 2016. Unë nuk të pengova, se po duesh me më qit prej kontrollit, po foli unë edhe tash me dalë keq para qytetarëve. Të lutem, ke durim pak kur të foli unë këtu! Në vitin 2016, Ministria e Shëndetësisë ka lyp bashkëpunim nga komunitat e Kosovës, që specifikat secila komunë që i ka, t'i qet në Ministri. Atëherë, në atë kohë, ka pas lëshime edhe prej qeverisë tonë, edhe qe ky Kuvend – e di mirë Arijeta edhe këta tjerët të vjetrit - kemi bo një Komision nga të gjitha partitë politike, nga një përfaqësues, për me shkue me bisedue me ministrin, kush ishte atëherë. Edhe atëherë, ata na kanë lejue. Sa për këtë mjekun ORL, këtu duhet në këtë Pikën 6 me e largue, se këtu po thotë deri në pension. Doktor Adnani ka shkue në 2019-tën edhe ky duhet me u largue, paragrafi prej këtij Nenit 6 duhet të largohet. Në QKMF në Dragash nuk lejohet të bëhet pranimi i specialistëve nga lëmitë e tjera, specilisti ekzistues nga lëmia ORL, që tani gjendet në kujdesin primar shëndetësor duhet të vazhdojë punën në këtë institucion, si konsultant, deri në pensionim. Këtë nuk e kemi edhe këtë paragraf duhet ta largojmë, të jetë vetëm mjeku pediatër dhe gjinekologu. Nuk kemi mjekë, kjo thotë duhet me pas, këtu nuk e kemi se ka shkue në pension. Këtu po thotë deri në pension, ai në pension ka shkue edhe nuk mundesh me marrë tjetër. Po nuk po lejohet, o doktor! Deri në pensionim po thotë. Për atë të thashë, këtë të ORL-së duhet me e largue krejt. Ai ka shkue në pension, tjetër s'un marrish, se po thotë deri në pensionim. Unë si asambleist po mendoj që kjo pikë duhet të largohet, për arsye se mjeku në shëndetin primar

shëndetësor...Neni 6: Në QKMF në Dragash nuk lejohet të bëhet pranimi i specialistëve nga lëmitë tjera. Specialisti ekzistues – nuk e kemi na – nga lëmia e ORL-së, që tani gjendet në kujdesin primar shëndetësor, do të vazhdojë punën në këtë institucion si konsultant i mjekëve familjarë, deri në pensionim. Ai ka shkue në pensionim edhe kjo mbyllet, edhe kjo për mu si asambleist duhet kjo pikë të largohet. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Drejtor, faleminderit për përgjigjen, po e dhaje një përgjigje e cila nuk më pëlqeu edhe s'ke adekuate për pyetjen të cilën ta parashtrova. Ne e dimë të gjithë këtu që një Statut, ne e dimë që po bazohet edhe thaje edhe në fillim të diskutimit që ky Statut është i formuluar prej Ministrisë. Mirëpo, edhe nëse Ministria e ka formulue edhe n aka dërgue neve, të gjitha komunave, të njëjtin shabllon, ajo bazohet diku, o drejtor. Bazohet me një ligj. Po pse more burrë s'e ke shënuë ligjin? Qekjo është ka më intereson mu. Shëno ligjin, se për detaje të cila po ndodhin, lëshimet që po i bëni ju, po na kthehen vendimet prapë. Shëno ligjin edhe kryhet puna, jemi shumë të qartë. Mos del me më dhënë përgjigje e cila, s'i ha unë këto fore edhe s'i pranoj këto përgjigje.

Jetmir Ajdini: Edhe një herë, Statutin e QKMF-së nuk e formulon Drejtorja e Shëndetësisë komunale, por e formulon Ministria e Shëndetësisë, e cila e sjell te na për votim. Çka duhet Drejtorja e Shëndetësisë është ta përmbajë atë Statut, t'u përmbahet atyre rregullave dhe atyre neneve të cilat përcaktohen në Statut, nene për të cilat unë besoj që, shumicën e tyre, Drejtorja e Shëndetësisë në Komunën e Dragashit nuk u përmbahet. Shumicën e pikave të cilat ceken në Statut, Drejtorja e Shëndetësisë në Dragash nuk iu përmbahet. Duke fillue prej stafit, nuk ka staf të mjaftueshëm. Drejtor, del sqaro, a e ke një mjek edhe dy infermierë për 2000-2500 banorë të cilëve duhet me u ofrue shërbime shëndetësore. Nuk e ke! E të gjitha pikat tjera me rend. Ne duhet të kërkojmë përgjegjësi nga Drejtorja e Shëndetësisë për përmbajtje në pikat e këtij Statuti. Nuk mujm me kërkue ndryshim, nuk e bëjmë na ndryshimin e Statutit. Ne duhet të kërkojmë përgjegjësi nga ky drejtor, edhe a do t'i përmbahet këtij Statuti të cilin do ta miratojmë ne sot.

Endrit Piraj: Përsëndetje për të gjithë! Statuti i QKMF-së nuk ndryshohet, as nuk modifikohet. Statuti i QKMF-së është dërgue nga Ministria e Shëndetësisë në formën e unifikuar për të gjitha komunat. Lufta jonë e vetme për Statutin ka qenë mbajtja e gjinekologut, për shkak se qendrat të cilat nuk kanë pasur maternitet dhe nuk kanë pasur gjinekolog në punë, u është larguar gjinekologu dhe pediatri, dhe nuk kanë të drejtë të punësimit të gjinekologut dhe pediatri. Ne jemi munduar maksimalisht për mbajtjen e maternitetit. Njëra prej arsyeve më të fuqishme që kemi mund me e mbajt maternitetin, prezenca tash e gjinekologes, si dhe largësia dhe gjerësia gjeografike e Komunës sonë. Statuti është i unifikuar dhe, në qoftë se ndryshohet, mund ta kthejë Ministria e Shëndetësisë edhe duhet prapë me e pru në Kuvend me u votue prapë. Ky Statut na u dërgue neve në formën e ngjashme, nuk kemi mundësi ndryshimi. Për ligjshmërinë e Statutit të QKMF-së është përgjegjës drejtpërdrejt drejtori i QKMF-së. Unë si drejtor jam munduar maksimalisht me e mbajt ligjshmërinë e Statutit të QKMF-së. Në të kaluarën ky Statut, asnjëra prej pikave të Statutit nuk ka qenë e rregulluar. U përmendën trupat punues të Statutit, këtë javë do të formohen trupat punues. Në vitin 2014, z.Artan Loshaj ka qenë pjesë e Komisionit Disiplinor, për komisionet që ai foli paraprakisht. Prej asaj kohe nuk ka pasur komisione dhe trupa të QKMF-së. Këta trupa do të formohen, shpresoj që puna në QKMF do të vazhdojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Kemi sfida, do të ia dalim bashkë, duke u munduar dhe duke pasur gjithmonë mbështetjen e njerëzve që dojnë me punue mirë për shëndetësinë në Komunën e Dragashit. Faleminderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Më vjen shumë mirë që ka debate për të mirë, dhe duhet të elaborohet çdo çështje në maksimum. Por një gjë po e them edhe të

gjithë le ta dinë: Komuna e Dragashit është Sui Generis. Sikurse Kosova që ka qenë në arenën ndërkombëtare Sui Generis, ne jemi Komunë Sui Generis. Kemi karakteristika të veçanta të cilat të gjithë akterët, edhe Ministria edhe ligji, neve na lejon me i bo disa gjëra, për shkak të specifikave që i kemi. Këtu tash po më vjen mu shumë keq që ndonjëherë po ndij do fjalime të cilat më herët ne i kemi kërkuar. Krejt këto specializimet ne i kemi kërkuar, këtu në Asamble, edhe në mandatet e kalume. Tash ka gjet Qeveria forma – se ligji nuk na ka lejue – ka gjet forma me i realizue. Ne duhet t'i japim mbështetje edhe Statutit, edhe këtyre formave që edhe në vazhdimësi të realizohen. E jo të bëhemi pengesë, sepse ne jemi Komunë specifike, dihet që terreni te ne është malor. Unë mendoj se edhe në buxhet Komuna jonë duhet të ketë status të veçantë, për arsye se në qoftë se një material në Prizren kushton 1 euro, këtu kushton 2 euro. Neve duhet të na jepet buxhet shtesë. Nëse neve na bën 4 milionë euro buxheti për investime kapitale, duhet të na shtohet në 8 milionë. Për arsye se jemi Komunë specifike. Ne kemi kërkuar vetë, kjo Asamble në vazhdimësi ka kërkuar që të ketë specialistë shtesë. Tash, s'po kuptoj unë. Faleminderit!

Driton Ademi: Unë e kam një pyetje për drejtorin. Drejtor, po më vjen keq, po të kanë përdorë me dalë këtu. Nuk ke kurrfarë kompetence për me dalë, se ti më së pari je i emëruar edhe plus je ushtrues detyre. Nuk ke nevojë për me dalë, derisa ne nuk të thirrjmë në interpelancë. E para, e dyta: Nuk ke nevojë ti për këtë, kur e ke drejtorin këtu për me i dhënë këto përgjigje të cilat ne po i kërkojmë. Kryesues, mirë që erdhe, se sot dy herë e ke shkelë, nuk i je përmbajt – se po duhet gjithmonë me jau përsërit, disa herë Uranin ia kam përsërit, ty ta kam përsërit – materialin të thashë edhe herën e parë, nuk u përgjigje, domethënë nuk e ke pru. Tash e bëre gabimin e dytë, që ja dhaje drejtorit të QKMF-së fjalën, pa lloj interpelance. Unë nuk e di qysh mundesh me ia dhënë drejtorit të QKMF-së, kurse e kemi ne drejtorin e Drejtorisë. E ka këshilltarin pranë aty që duhet me e udhëzue. Tash na po e marrim edhe ndonjë drejtor të shkollave edhe dikond, edhe të OSBE-së, kur dojnë le të dalin edhe le të folin këtu kur të dojnë këta. Nëse dona me iu përmbajt rregullave të Kuvendit, po i përmbahemi pak me rregull, ose po vazhdojmë qeshtu sallamadi, qysh jemi mësue.

Nedžmidin Sejdlar: Unë ndaj kritikën e zotit Ademi dhe mendoj se është e vrazhdë, e pavend që të lejoni një ushtrues detyre të vijë këtu në foltore për të folur. Atëherë pse shkuam në zgjedhje. Nëse dikush mund të vijë të flasë jashtë protokollit, jashtë rregullores së kuvendit, mos i bëni ato, ne kemi kryetarin e komunës këtu, kemi drejtorët e tij, e dimë që drejtorët e tij nuk janë në gjendje të drejtojnë drejtorinë. ua ka besuar, por çfarë do të bëjmë tani, le ta gjejë rrugën mes vete. Në lidhje me zotin Brenoli do t'i bëj shumë pyetje të lehta, të cilave ai me shumë mundësi do t'i përgjigjet. Pyetja e parë: a ka sistem kullimi stadiumi ne Dragash, pyetja e dytë a vendosin gome ne tubacionet e kanalizimeve dhe pyetja e tretë a vendosin najlon nën kubza, ai e di me se miri, nuk e kemi pare. atë në shëndetësi, as punonjësit e mjekësisë nuk e kanë parë Brenolin në shëndetësi. Brenoli është kudo ku ka tendera, ku po shtrohet diçka, ku ndërtohen kanalizime. Nuk mund të jetë vetëm drejtor i kanalizimeve.

Munir Jonuzi: Disa prej nesh delegatët kërkuar heqjen e pikës 6 nga neni gjashtë i statutit, që thotë se specialistët ekzistues të ORL qëndrojnë këtu deri në pension. Këtë propozim e kemi paraqitur në bazë të rregulloreve ligjore, pra në bazë të një udhëzimi administrativ. Dhe sipas udhëzimeve të reja administrative, kjo kategori nuk përmendet fare, pasi në të ardhmen, si qendra kryesore e mjekësisë familjare, nuk kemi të drejtë të punësojmë otolaringolog. Kjo është bërë në bazë të statutit të vjetër dhe i ri thotë, në fushën e ekspertëve shëndetësorë në kujdesin parësor shëndetësor, neni 3 thotë, ekspertët e fushave të tjera mund të vazhdojnë punën në kujdesin parësor shëndetësor si konsulentë të mjekëve të familjes deri në pension. . Ne që kërkuam që kjo të hiqej thjesht donim ta përputhim këtë me udhëzimin administrativ. Dhe të mos bësh diçka që bie ndesh me të njëjtën gjë. Nuk kemi të drejtë

ta bëjmë këtë dhe sugjerojmë që të hiqet sepse është mbetje e një udhëzimi të mëparshëm administrativ që sot është i pavlefshëm. Shpresoj të isha mjaft i qartë. Faleminderit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pasi u ngritën shumë kërkesa rreth këtij Statuti, edhe pasi disa asambleistë nuk po e zënë drejtorin e Shëndetësisë, atëherë e kisha lut drejtorin e Administratës me na dhënë një sugjerim ose diçka rreth kësaj pikës.

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesuese! I nderuar kryetar, të nderuar asambleistë, media dhe të gjithë qytetarët që po na ndjekin! Deshta pikë së pari të ndërlihem, meqenëse qysh nga fillimi i seancës u potencua nga asambleisti Driton Ademi – me të drejtë – mosshpërndarja e materialit. Realisht, unë në cilësinë e drejtorit të Administratës, ju kërkoj ndjesë për këtë lëshim që ka ndodhë! Nuk dua ta arsyetoj, mirëpo kemi pasur edhe disa arsye të organizimit të brendshëm. Siç e dini, edhe një zyrtar i yni tashmë ka ndërruar jetë, që shfrytëzoi rastin ta ngushëlloj edhe familjen prej foltores. Pra i ndjeri Hylki Hasani, ai ka qenë përgjegjës për shpërndarjen e kësaj dhe ne, besoj që qysh nga seanca e ardhshme do të fillojmë që të ju dërgojmë materialin ashtu siç jemi dakorduar në seancën paraprake. Në lidhje me Statutin e QKMF-së, poashtu edhe unë e kam lexuar materialin, edhe si drejtor i Administratës kam vërejtur që Statuti nuk e ka qysh në start preambulën, ku precizohet – që e potencoi asambleisti Shpetim Hajredini me të drejtë – se duhet të precizohet ku thirret dhe nga buron ky Statut. Së paku ashtu si e kam lexuar në statutet e mëhershme, ndonëse është shabllon nga Ministria, duhet që t'i shtohet se thirret në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Shëndetësi. Poashtu, një gabim tjetër është potencuar me të drejtë, me aq sa e kam përcjellur nga asambleisti Munir Jonuzi, pra ende ky Statut thirret në Ligjin për Procedurat e Shërbimit Civil, kur realisht ne e dimë që ky ligj ka tashmë thuar një vit që është shfuqizuar. Andaj, ju kisha propozue edhe juve, edhe kryesueses, në qoftë se kemi mirëkuptimin tuaj që =, meqenëse nuk është ndonjë punë urgjente, pret koha, puna në QKMF nuk do të ndalojë nëse Statuti nuk kalon sot. Unë po besoj që duhet ta shikojmë edhe një herë, ta lexojmë edhe një herë Statutin, t'i shohim plotësim-ndryshimet e mundshme, të konsultohemi edhe me Ministrinë dhe pastaj të vjen një draft final që do të jetëm besoj, pa problem nga e gjithë Asambleja. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër? Kemi diskutue shumë për këtë. Të lutem, Nedžmidin Sejdić, unë i di krejt rregullat, për atë arsye jam votue dhe kam ardhë këtu. Hera e fundit që ta tërhek vërejtjen!

Artan Loshaj: znj.Kryesuese, kur nuk keni mund këtë Statut me e koordine të gjithë pushteti, pse na latë dy orë me diskutue? Edhe e dyta, fjalët e opozitës po janë me vend, për arsye se drejtori i Drejtorarit të Shëndetësisë nuk merret me shëndetësinë, po merret me urbanizmin. Domethënë, të gjitha këto diskutimet tona që kenë, dolën në pah që nuk keni koordinim, drejtori i Shëndetësisë me kryetarin e me këtë. Edhe të lutem, herave tjera bini me rregull këto sende, ose këto mosmarrëveshjet që dolët përjashta me kryetarin me i diskutue, po e shtyjmë e s'po e shtyjmë, është mirë me kohë, mos me lënë ora me u bo 12:00, na mos me fillue mbledhjen.

Jetmir Ajdini: Edhe një herë, Statutin e QKMF-së e përcakton Ministria e Shëndetësisë, mbështetur në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Element bazik që drejtori i Shëndetësisë duhet ta dijë. Janë mbajt takime, janë mbajt grupe punuese për themelimin e këtij Statuti, i cili është unifiku në të gjithë Republikën e Kosovës, me specifikat në komunat e veçanta. Nuk ka diçka të paqartë. Na çka duhet të kërkojmë prej drejtorit të Shëndetësisë, t'i përmbahet këtij Statuti. Ky është Statut i cili i përfshin të gjithë Republikën e Kosovës. Ne nuk mund të ndryshojmë asnjë nen të tij, se nuk varet nga Kuvendi Komunal. Kuvendi Komunal veç e miraton qato që e bjer Ministria e Shëndetësisë. Është

shumë e thjeshtë edhe nuk ka nevojë për sqarime më tepër. E pse drejtori i Shëndetësisë nuk i ka këto njohuri bazike, është problemi i drejtorit pse s'merret me Drejtorinë e Shëndetësisë. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Nëse kemi pak durim me dëgjue! Po më vjen mirë, së pari do ta përshëndes drejtorin e Administratës, jo për postin e ri, po nganjëherë edhe gabimet të cilat bëhen, duhet dikush me i bart përballë edhe duhet me thënë më falni një herë. Më erdh mirë që doli këtu, e ka lexue shumë mirë, tha e kam lexue, e kam pa që ka lëshime, ka gabime. Por, drejtor, pse na prutë deri këtu, veç deshta me të pyet? Nëse e keni vërejtur se ka gabime, pse e qitët në votim. E Para, e dyta: Pse e latë drejtorin e Drejtorisë – s'po them unë të Urbanizmit, po të Shëndetësisë, me u maltretue këtu, e s'dike kah me dalë. Ne, nuk do të thotë se pyetshim pa vend, të gjitha pyetjet të cilat ishin nga kolegët – unë nuk i përkas asaj fushës – po kolegët që i përkasin fushës m'u duk se me plot të drejtë e pyetshin, ai s'dijke kah me ik, kah me shkue. Pse e laje me e maltretue këtu? Është mirë, ta pranove plotësisht edhe po ta pranoj, që dole e thaje se e kemi lexue, e kemi shikue, ka mangësi, do t'i përmirësojmë, do të mundohemi t'i përmirësojmë. Kështu që, mos na lini me dalë këtu me u maltretue kolegët, që dy orë i humbëm. Me kohë u desht, e para nuk u desht me e pru hiç fare në votim. Po masi e prutë, kur e patë që po ka debate edhe po është debate i frytshëm për një të ardhme të shëndetësisë, pasi që është sektor i ndijshëm, nuk u desht me na lënë dy orë, dy orë e gjys, me i humb kot. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Faleminderit që më tërhoqët vëmendjen. Kërkoj që edhe t'i tërheqni vëmendje të tjerëve sepse tani ndihem i diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike. Ju nuk ja terhiqni veretje askujt këtu përveç meje. Populli na zgjodhi që të flasim këtu dhe qeveria e shkëlqyer të na dëgjojë. E di që keni një takim të planifikuar në Prizren, nuk e keni planifikuar mirë seancën, siç nuk e keni bërë kurrë më parë. Unë do t'i kërkoj OSBE-së të anuloj pleskavica deri ne ora 5 që të mund të mbarojmë punën tonë këtu..

Vetim Ramadani: Atëherë, meqenëse kërkoj asambleisti Selaj që t'i përgjigjem në lidhje me pse ne u maltretuam me këtë pikë. Realisht, unë këtë nuk e konsideroj që është maltretim. Përkundrazi, nëse dikush duhet që pa diskutim veç t'i ekzekutojë jemi ne, ekzekutivi. Ju jeni për me i diskutue, me i shikue opsionet më të mira të mundshme, edhe ju na sjellni ato të cilat ne duhet të mos i diskutojmë. Unë besoj që Asambleja është organi më i lartë i një vendi, qoftë në nivel lokal, qoftë në nivel qendror. Këtu ju diskutoni, ju i shikoni opsionet më të mira për vendin dhe për shoqërinë, për atë jeni edhe të zgjedhur. Ndërsa, neve na mbetet vetëm me i zbatue. Ndoshta, sa i përket këtyre ndryshimeve që unë i përmenda, janë çështje teknike-administrative që duhet t'i përmbajë secili statut apo rregullore. Nuk është diçka që nuk bën pa të, mirëpo është mirë, meqenëse është një dokument. Nëse nuk gaboj, Statuti i kaluar ka qenë i vitit 2016, do të thotë janë diku afërsisht 8 vite që është kohëzgjatja e këtij Statuti. Ky ndoshta që do të votohet, do të jetë edhe dhjetë vite e më tepër. Kështu që, përderisa po hartojmë, si Asamble, një dokument që mund të shkojë mbi dhjetë vite, pse mos ta kemi në formën më të mirë të mundshme, edhe brezat që do të vijnë ta lexojnë, të jetë një artikull i kompletuar edhe mirëfilltë i hartuar. Kështu që, fjala ime ishte më shumë në këtë pikë, ndërsa vijat e trasha – e potencoi edhe asambleisti Jetmir Ajdini – këto vijnë nga Ministria, është një template, një shabllon që vjen për secilën komunë. Ajo çka mbetet janë disa ndryshime kozmetike, ta zëmë ndryshohet emri i kryetarit, sepse secila komunë e ka kryetarin me emër të përveçëm. Nuk ka diçka përmbajtësore që mund të ndryshohet. Madje-madje, unë me sa e kam lexuar, në Statut – kam edhe disa shënime – gjithsej janë Neni 6 ndryshohet. Asnjë ndryshim tjetër nuk ka, është Neni 6, te Pika 5, janë tri kategori që shtohen, është specialist i pedodontësisë dhe preventivës, tekniku i farmacisë dhe teknik asistent i stomatologjisë. Vetëm këto tri pika shtohen nga Statuti i vitit 2016. Kam përcjellur me radhë secilën pikë të Statutit. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Atëherë, kush është për me e çue këtë pikë të rendit të ditës në seancat e radhës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 13 vota pro, zero kundër dhe 8 abstenim, kjo pikë shtyhet për në seancat tjera. Atëherë fillojmë te pika e dytë; Miratimi i Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026.

Zeni Krasniqi; Faleminderit! Unë si drejtor i Arsimit kam për obligim që ta dal të prezantoj Planin e Veprimit. Ju materialin e keni marrë, po në pika të shkurta unë do të shkoj se si ka rrjedhë kjo, deri në formimin e këtij Ekipi. Në mbështetje të Nenin 3, Nenit 5, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.4, Parapagrafi 16 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 6, Pika 1 të UA të MASHTI-t Nr.08/2018, për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, DKA-ja ka marrë këtë Vendim për formimin e Ekipit për Parandalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar. Me këtë Vendim formohet Ekipi, numri i përgjithshëm i tij është nëntë anëtarë: dy përfaqësues nga DKA-ja, i treti është kryetar i Këshillit të Prindërve, i katërti përfaqësues i mësidhënësve, kryetari i Këshillit të Nxënësve, një drejtor i shkollës, një përfaqësues nga QPS-ja, një nga DShMS, dhe një nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Detyrat e Ekipit janë të përcaktuara më Nenin 6 të UA Nr.08/2018. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen anëtarët e Ekipit dhe DKA-ja në Dragash. Ky Ekip, në bashkëpunim me MASHTI-n, DKA-në, UNICEF-in dhe ECMI-në, e ka përgatit këtë Plan të Veprimit për periudhën trivjeçare 2024-2026. I njoftoj delegatët që në të gjitha shkollat janë të formuara edhe këto ekipe. Ato gjithsesi bashkëpunojnë me Ekipin komunal. Qëllimi i Planit të Punës së këtij Ekipi koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor, në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes. Janë dy objektiva të përgjithshme, e para është parandalimi dhe identifikimi i hershëm i nxënësve me rrezik të braktisjes, ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i përmbushur ato, si këshillim, mbështetje dhe monitorim; dhe objektiva e dytë është ulja e përqindjes së braktisjes së shkollës, duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës, që përputhen me aftësitë dhe interes të nxënësve. Objektivat specifike të cilat ju me siguri materialin e keni lexue, janë të paraqitura në formë tabelare, që na kanë ardhë nga Ministria e Arsimit, dhe këto paraqesin numrin rendor, aktivitetet që do të zhvillohen, treguesit, afati kohor, institucioni përgjegjës, institucionet mbështetëse, si dhe është paraparë një kosto. Ne e kemi planifikuar buxhetin, a do të realizohet apo jo, nuk e dimë. Ky do të ndahet prej buxhetit të DKA-së, si dhe kemi një premtim shumë të madh edhe nga Ministria. Unë do të ndalem shkurt kështu, ju i keni të gjitha, për mos me i përsërit. Në Komunën tonë e dini që janë funksionale 36 objekte shkollore, dhe atë 12 shkolla amë, 23 shkolla paralele dhe një shkollë e mesme e lartë. Për vitin shkollor 2023-2024 i kemi gjithsej 3041 nxënës. Braktisjes së shkollës – ne mund të themi, në krahasim me disa komuna tjera, nuk kemi numër shumë të madh të braktisjeve – por e kemi një statistikë se gjithsej janë 9 nxënës, 5 janë të ShFMU “Fetah Sylejmani” në Dragash dhe 4 në Gjimnazin “Ruzhdi Berisha”. Kemi 41 nxënës pa njërin ose dy prindërit, 13 nxënës me aftësi të kufizuara, 12 nxënës me vështirësi në të nxënë, 22 nxënës me mungesa të shumta, me rrezik të braktisjes 4 nxënës. Unë mund të jau jap edhe një statistikë sot këtu, megjithëse vazhdimisht na kërkohet ngë MAPL-ja, duke e marrë parasysh këtë trendin e levizjeve kohëve të fundit. Për periudhën trevjeçre kemi një lëvizje shumë të madhe, diku 45 nxënës na janë larguar brenda periudhës janar-mars, këtë vit. Unë më shumë nuk ju kisha ndalë, ju kisha dhënë juve mundësi, gjithmonë duke ju lutur të bëni pyetje, vërejtje ose reagime vetëm në kuadër të këtij Plani. Për tjera pyetje, nëse keni, jemi të gatshëm në çdo moment, në afatin më të shpejtë të

paraparë, mund të ju japim përgjigje, qoftë edhe përmes emailit. Përndryshe, nga ju kërkoj sot që ta votoni këtë Plan të Veprimit. Unë ju falënderoj për vëmendjen!

Nexhat Selaj: Drejtor, të përcolla me vëmendje, shumë shkurt i raje. Pasi që unë, veç si pjesëtar i kësaj fushe, më është dashur dy apo tri orë të lexoj dhe ta saktësoj mirë përmbajtjen e këtij Plani të Veprimit. E për pesë minuta, s'e pashë shumë të arsyeshme me dalë edhe me u kthye mbrapa. Unë jam shumë i sigurt se – s'po them pjesa dërmuese, mirëpo shumë realisht nga asambleistët të cilët i kemi këtu prezent, s'po them 100% se po bëhet komunizëm, veç mbi 95% nuk e kanë të qartë se çfarë përmban kjo. Unë mendova se do të mbash një fjalim të paktën nja 30 minuta, që për secilën fushë edhe pikë do të japësh pak sqarim, por ike shumë shpejt. Unë do të ndalem pak tek ky Grupi i përzgjedhjes së nëntë anëtarëve, ky Ekipi, ta bëj një pyetje. Kush do ta bëjë përzgjedhjen e këtij grupi planerësh, që ne e quajmë, prej nëntë anëtarëve, të cilëve fushave do të jenë, të cilave profileve do të jenë. E dyta, është një shumë prej 70 mijë eurove të ndara përafërsisht – më saktësisht ishte 69,730, mos gabofsha, rreth 70 mijë – dhe pjesa më e madhe e këtyre mjeteve do të ndahet nga DKA-ja dhe nga Komuna. Një pyetje do të është për ju, nga cila fushë e investimeve nga DKA-ja do të merren këto para dhe do të mbulohen. Dhe një pyetje për kryetarin apo ekzekutivin në përgjithësi, nga Komuna nga cili sektor do të merren, do të bazohen këto para që do të barten, të investohen në këtë projekt? Sigurisht që do të kemi edhe pak më vonë, nëse më japësh përgjigje për këto.

Jetmir Ajdini: Kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, pyetje të cilën ia kam bo qe disa kohë, edhe drejtorit, edhe kryetarit edhe të gjithëve. Në lidhje me transportin e nxënësve të cilin e organizon Komuna. E kam cek disa herë që nxënësit e fshatit Zgatar, pjesa e fshatit nalt, nuk ka transport. Transporti organizohet vetëm nga pjesa e fshatit poshtë. Ata nxënës detyrohen të ecin gjysën e rrugës në këmbë. Edhe pse Komuna e paguan kompaninë, edhe pse ajo kompani paguhet nga taksat tona, ata fëmijë, prindërit e tyre paguajnë taksa, por transporti prapë se prapë nuk iu organizohet. Edhe pse kam marrë premtim disa herë, prej drejtorit e prej të gjithëve nga ekzekutivi, që do të organizohet ai transport, ende sot nuk bëhet ai transport i nxënësve. Faleminderit!

Zeni Krasniqi: Kërkoj edhe prej të gjithë tjerëve, e keni qëllimin e mirë, që është edhe i joni, i ekzekutivit, edhe i krejt kësaj popullate. Punojmë në atë drejtim, që të mos kemi braktisje dhe mosregjistrim të nxënësve, megjithëse thashë, jemi Komunë pak – në krahasim me disa komuna tjera që janë minoritete, ata kanë shumë braktisje – ne jemi mirë për momentin. Ne, gjithçka që kemi bërë për me e përgatit këtë Plan, në të mirën e qytetarëve, për siguri dhe për mirëqenie të nxënësve. Thaje se çka përmban ky Plan, nuk e kam shumë të qartë, unë nuk e di, si ta ke lexue, ky Plan është shumë i përgatitur mirë. Unë thashë juve të ju jap hapësirë që të bëni pyetje ose nëse keni ndonjë vërejtje. Përndryshe, ky Plan, ka punue një ekip një kohë të gjatë, me një përbërje dhe mbështetje thashë prej kujt. Edhe ka dalë si një plan që besoj se është shumë i qartë. Neve na mbetet veç me përkrahjen e juaj, të kryetarit dhe Ministrisë, që ky Plan të ekzekutohet. E dyta, përzgjedhja e Ekipit – s'e di, nashta në atë moment nuk më ke dëgjue – thashë bazuar në UA 08/2018, është marrë Vendim dhe është përzgjedhë ekipi prej nëntë anëtarësh. Edhe këta janë: një zyrtar i DKA-së që është si kryesues, i dyti prapë zyrtar i DKA-së, i treti është kryetari i Këshillit të Prindërve, i katërti përfaqësues i mësimdhënësve, i pesti është kryetar i Këshillit të Nxënësve, i gjashti është drejtor i shkollës, një përfaqësues i QPS-së, i teti është një përfaqësues nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe i nënti është Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Është përzgjedhë në bazë të Udhëzimit Administrativ. Për këtë është i njohur edhe kryetari, ne jemi bashkue edhe është formue qe ky Ekip dhe e ka këtë përbërje. Për shumën e ndarë, unë të thashë, ne kemi përkrahje, do të kemi mbështetje që na kanë premtue Ministria e Arsimit, mirëpo me kryetarin do të gjejmë mundësi që në pozicione të ndryshme, po edhe prej DKA-

së, do të mundohemi që të ndajmë mjete dhe ky Plan të realizohet. Megjithëse kjo s'ka të bëjë me Planin, doktor – e falënderoj drejtorin e Administratës që tha për atë se mund të gabojmë, sepse të pagabueshëm nuk ka – vitin e kaluar, jo që kemi gabue, megjithëse kemi bërë përpjekjem, mirëpo duke iu falënderue edhe kryetarit, ne e kemi cek edhe në Plan të Veprimit, një ndër ato që janë mirënjohës popullata, mirëpo sa ka ndikue në rritjen e numrit të regjistrimit të nxënësve në Gjinnaz, me siguri ka ndikue shumë sigurimi i transportit falas për nxënësit. Jo që kemi bo gabim, po ndoshta unë po e marr gabim, se nuk e kam cek, për shembull prej te varrezat ose ku është vendi Zgatar. Nuk e kemi vetëm Zgatarin, e kemi edhe Breznen, Buqen edhe Rrencin. Por, një gjë duhet ta keni parasysh, në sezonin e dimrit, kemi dimra të ashpër...nëse kemi bo gabim, doktor, vitin e kaluar, këtë vit nuk do ta lëshojmë këtë gabim. Edhe unë do të vë pika të caktume prej Zgatarit, do të pyes ty me ma dhënë emrin prej cilit lokacion do të niset qoftë autobusi ose kombi. Autobusi është e pamundshme me hy, ne disa herë kemi reague te këta operatorët. Ti e bart zërin e qytetarëve këtu edhe unë po të përgjigjem ty, edhe ata me siguri dëgjojnë sot këtu. Nuk është hera e parë, te unë kanë qenë në zyrë edhe të fshatrave tjera, nuk është bo ndonjë gabim me qëllim, por këtë do ta përmirësojmë këtë vit. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Drejtor, nëse ke pak durim e më dëgjosh! Unë shumë me vëmendje të dëgjova, por të kesh mbi supe 3 mijë e sa nxënës, 500 e diçka arsimtarë, me një Plan Veprimi trevjeçar, për pesë minuta ta përshkruash dhe të thuash e keni në material. Unë shumë mirë e kam lexue edhe e kam në material, po këtu ne nuk jemi që të koordinohemi vetëm ne asambleistët me drejtorin, po këtu jemi edhe para qytetarëve, duhet edhe qytetarët këtu, pak më thjeshtë të zbulohet ky Plan veprimi që edhe qytetarët të dinë. Besoj se një pjesë e madhe e prindërve marrin njohuri për këtë Planin komunal të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve. Sa i përket asaj që thajë këtë vit kemi fillue me transportin e nxënësve, nuk do t'i përsëris edhe një herë fjalët e z.Ajdini, doktorit, qa tha se bartja e nxënësve nuk po bëhet, që ecin gjysmën e rrugës në këmbë. Unë do të kërkoj vetëm shifra nga ju, se jam i thirrur vetëm me shifra që të flas. Ju sigurisht e keni numrin e nxënësve semimaturantë të vitit të kaluar, sa kanë qenë. Kjo bartje e nxënësve, a ka ndikue edhe sa ka ndikue që ta zbusë me një formë shkuarjen e nxënësve jashtë territorit, sa nxënësia ke shtesë që të kanë ardhë gjatë këtij vitit? Faleminderit!

Agron Gashi: Në Planin e Veprimit komunal për mosregjistrim të kuadrove në Komunën tonë, kjo shpeshherë, edhe gjatë debatit me kryetarin nëpër televizione që për të parin e Komunës kemi debatuar, është folur shumë për shkollën profesionale. Ne e dimë se shkolla ekziston dhe kjo shkollë asnjëherë nuk u bë e realizueshme që të rinjtë tanë, të rejat tona të marrin qasje dhe njohuri në shkollat profesionale të kësaj Komune. Atëherë, në mungesë të kësaj, po konsideroj se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve tanë marrin rrugëtim në drejtim të Prizrenit. Atëherë janë disa shkaqe: Ndoshta numri i vogël s'po mundet të funksionojë, apo në mungesë të kuadrove për të aktivizuar këtë shkollë këtu, profesionale, unë po i besoj termit tjetër që, po sikur të ishte shkolla profesionale, atëherë një numër goxha më i ngjeshur i të rinjve tanë, të rejave tona, do të vazhdojnë procesin mësimor në këtë Komunë. E gjithë BE-ja jep rekomandime të ndryshme, thotë: Po i drejtohem Kosovës, por mungojnë kuadrot. Mungojnë njerëzit profesionistë. Por, e keqja e kësaj është se edhe ato shkolla profesionale në drejtim të Prizrenit, pasi po mbarojnë një lëmi, nuk janë në gjendje të ushtrojnë atë veprimtari, në mungesë të cilësisë. Dhe, po sikur cilësia të ishte në nivel të duhur dhe ne t'i qesim të rinjtë me profesione, edhe BE-ja do të ishte shumë e gatshme që me mjetet e tyre, biznesmenë nga e gjithë Evropa dhe vendet e tjera, do t'i drejtohen këtij vendi për të ardhë dhe për të investuar. Se po thojnë ata, po sikur po vijmë dhe hapim një fabrikë, po duhet të fillojmë nga zero, se edhe kuadrot që duhet t'i punësojmë aty, duhet edhe një herë të ndjekin procesin, apo profesionet. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: A do edhe dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Dëgjo Artan, unë nuk i them merre, në qoftë se nuk e ngre dorën me e marrë fjalën, unë nuk e obligoj. Të lutem, unë dy-tri herë pyeta kush don me e marrë fjalën.

Artan Loshaj: z.Drejtor, dje në Komitet të kam kërkue, të kërkoi edhe profi Nexh, numrin e nxënësve të vitit të kaluar të cilët e kanë krye semimaturën, klasët e nënta, sa është numri i tyre edhe sa nga këta janë regjistruar në Shkollën e Mesme të Lartë “Ruzhdi Berisha”. Dje ke qenë i papërgatitur, se s’e ke ditë pyetjen, më ke thënë që sot në Kuvend do të biesh shënime. E dyta, është një pyetje për juve edhe për kryetarin, edhe për ish-kryetarin e LDK-së që ka qenë në fushatë – se e kam incizue prom, e kam përcjellë tanë natën, me motrën Ventazë kemi qenë kujdestar – është një premtim i juaji që na keni akuzue asambleistin Shpetim Hajredini në fushatë, që shkolla profesionale është investim milionësh, nuk është funksionale, me ardhjen e LDK-së do të bëhet funksionale, do të vijnë drejtime të reja, do të ndalohet migrimi i studentëve, i nxënësve tanë për Prizren. Sa keni arrit, a do ta hapni, kur do ta hapni, ose, me siguri e keni lënë për vitin tjetër që janë zgjedhjet, e me e pre shiritin. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Nuk po dua – drejtor – të replikoj, por kur kërkosh diçka me ditë, që m’u drejtove thajë a e ke lexue, unë e kam lexue, tash po të lypj sqarim. Eja këtu dhe fol. Tash unë s’po di, të kesh mbi supe mbi 3 mijë nxënës, të kesh mbi supe rreth 400 e sa arsimtarë, profesorë të profileve të ndryshme, edhe me pesë minuta që të flasësh për Planin e Veprimit, nuk është kjo vetëm që ne ta dimë. Këtu në dëgjon neve edhe popullata, na dëgjojnë edhe dëgjuesit, këtu duhet të thehet pak ky Plan veprimi, se edhe prindërit janë duke na dëgjuar. Ky ekip planerësh, sa do të punojë? Nëntë anëtarë, është krejt diçka tjetër, po shfrytëzo pak momentin edhe nga këtu që të dëgjijnë pak edhe prindërit se çfarë do të ketë mbi supe ky Plan i veprimit. Të pyeta, nga vitet paraprake, sa keni arrit që t’i ndalni – se keni harxhue me qindra e mijëra euro për transportin, bartjen e nxënësve. Sa nxënës na kanë ikur sivjet, a keni regjistër të nxënësve semimaturantë, sa e kanë përfundue vitin edhe sa nga këta ne nuk i kemi këtu. Edhe, çfarë duhet të bëjmë bashkërisht, që të nxjerrim, që një numër shumë i vogël të na ike nga territori jonë. Tash ti po bisedosh atje, nuk po ke përgjigje këtu, foltorja është për ju, drejtor, nuk është për ne. Për ne është me të pyet, ti këtu duhesh me dalë me u dirs., e jo ne. Faleminderit!

Zeni Krasniqi: I nderuar delegat, tip o insiston që unë ta lexoj një material që është 26 faqe, po unë thashë që ky ka kaluar edhe fazën e dëgjimit publik. Ata të cilët kanë qenë të interesuar, me siguri ka qenë në uebfaqe, po edhe këtu e kemi pas dëgjimin publik. Ata që kanë qenë të interesuar kanë marrë pjesë. Ta lexoj këtë material 26 faqe, ndoshta mos bëhet e tepërt edhe s’e di a keni ju vëmendje me më dëgjue mu. Unë thashë në pika të shkurta, ju dhashë juve hapësirë më tepër. Përndryshe, e kërkoi numrin e nxënësve nga viti i kaluar, kemi pas gjithsej semimaturantë 249 nxënës, kurse në Gjymnazin tonë “Ruzhdi Berisha” janë regjistruar 129. Tash për drejtime mundesh me iu drejtue drejtorit të shkollës, se i kemi. Këtë vit presim – se tash është koha e regjistrimit. Për shkollën profesionale mund të ju jep përgjigje kryetari.

Nexhat Selaj: Zeni, a po duesh veç me nxit me dalë këtu, apo s’po ke përgatitje? Sipas këtij Udhëzimit, pika 1,2,3, duhet të raportosh, se të shkruan këtu, për bursat e nxënësve. Cila kategori i nxënësve do të marrë bursa, a do të ketë kategori të nxënësve të cilët do të jenë shembullorë, që ty të takon këtu të flasësh e ne të pyesim. Jo që ta përshkruash vetëm për pesë minuta. Unë po pres që ti t qesish debatin, e ne të pyesim. Thotë “Mbështetja e nxënësve me bursa dhe stimulime të tjera”. Çfarë stimulime? Te braktisjet, po, çfarë stimulime do të ketë? Foltorja është për ju, që ti të flasësh dhe do të dëgjojnë prindërit, do të dëgjojnë nxënësit, se dikush dëgjon këtu. Mos mendo se do të ecësh për pesë minuta, Drejtorinë e Arsimit si ta kalosh. Ti duhesh të flasësh këtu, e ne të pyesim. Jo pesë minuta të dalësh këtu edhe të shkosh në vend, të thuesh u krye puna.

Jetmir Ajdini: Atëherë, edhe një pyetje për drejtorin e Arsimit. Në Pikën 2.3 ceket krijimi i partneritetit me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike për nxënësit e shkollave të mesme. Cilën lëmi profesionale e përfshin, përveç lëmisë së mjekësisë që e përfshin shkolla profesionale, cilën lëmi profesionale e përfshin Shkolla e Mesme në Dragash që ne mujm me iu ofruar bizneseve nxënësia për punë praktike. Ju lutem një sqarim, drejtor!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Jetmir! A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Të nderuar delegatë, pasi që ne jemi të ftuar në 25-vjetorin e OSBE-së, ju kisha lut që të mos dalim në pauzë, për arsye se jemi të thirrur unë, kryetari i Komunës, shefat e grupeve, dhe për arsye se ata na kanë vëzhgim që shumë seanca, ju kisha lut që mos të dalim! Faleminderit, atëherë po e shoh të arsyeshme që me fillim te pika e tretë e rendit të ditës: Vendimi për hartimin e PZHK-së 2024-2032.

Shpetim Hajredini: E nderuar kryesuese, nuk e mora fjalën për pikën e rendit të ditës, por do të kthehem mbrapa nja dy minuta, për atë problemin që e bëre në fund. T'u kisha lut se diskutimet pa u përmbyllë, pa qenë të kënaqur të asambleistët, pa i marrë përgjigjet nga ekzekutivi, nuk do të hedhësh në votim një vendim, çfarëdo që të jetë ai. Në qite në pozitë të palakmueshme. Nuk isha kundër, as grupi të cilin e përfaqësoj nuk ishte kundër. Është dashtë vetëm ta marrë përgjigjen profi Nexhat edhe një herë nga drejtori, të cilën ia parashitroi, dhe ne ishim pro. Të keni kujdes, është mirë që – okej, kjo kaloi – po në të ardhmen mos të ndodhë një gjë e tillë. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Shpetim! Kjo nuk më bjer barrë mu, për arsye se unë dy-tri herë pyeta a ka dikush me e marrë fjalën. Të njëjtin mendim e ndaj edhe unë, Shpetim. Në qoftë se ai nuk ka pas përgjigje, u dashtë me na dhënë pak pauzë ose diçka, po drejtori i Arsimit nuk dashti edhe unë askënd nuk e shti me zor.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, unë propozimin dhe arsyetimin për futjen në rend të ditës si pikë e jashtëzakonshme Vendimin për hartimin e PZHK-së 2024-2032, arsyetimin e dhashë. Nëse ka nevojë me e arsyetue edhe një herë, unë e arsyetoj, mirëpo ma merr mendja që s'kam nevojë me humb kohë. Unë kërkoj nga delegatët, pozitës dhe opozitës, të gjithë bashkë, se ky PZHK është, si me thënë, kushtetuta e Komunës. Është plan shumë i rëndësishëm, pa të cilin Komuna nuk mund të funksionojë, dhe ju kisha lut që këtë PZHK, me këto ndryshime që i ka lyp Ministria, disa nene këtu ndryshohen plotësohen, edhe ta miratojmë këtë Plan, në mënyrë që mos të humbim kohë, sa më shpejt ta kemi PZHK-në Komuna jonë, në afat më shumë se tetë vite. Faleminderit!

Uran Halimi: Meqenëse na është kthye prapë edhe po besoj që këto gabimet tanimë janë evitue edhe janë përmirësue, është edhe pika që e kemi mbështet në seancën paraprake, patjetër që duhet ta mbështesim edhe t'i përfeksionalizojmë gjërat kur na kërkohet. Ne si Grup Parlamentar i LVV-së kemi marrë vendim që këtë pikë të seancës duhet ta mbështesim edhe do ta mbështesim. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Për këtë pikë të rendit të ditës edhe për pikën tjetër të cilat materiali na erdhi dje, kena diskutue edhe në seancën e kaluar, një kohë të gjatë e kena diskutue këtë problematikë, e cila na përsëritet neve në çdo seancë. Me vëmendje e kam dëgjue edhe kryetarin për atë arsyetimin e Ministrisë, që e ka bo edhe për një rishqyrtim. Unë e kam kërkue në disa herë, në disa seanca. E nderuar kryesuese, tash ty po të drejtohem, jo ekzekutivit, jo kryetarit. Besoj që është ligjore, po është edhe morale, që të na vijë – qe s'di sa herë po e përsëris – arsyetimi i Ministrisë të na bashkëngjitet me materialin që na vjen në seancën e ardhshme. Ta lexojmë, s'besoj që është diçka e madhe që të bashkëngjitet, e kam thënë, e kam ritheksue disa herë, një fletë A4 të na bashkëngjitet, të na vijë edhe neve, që ta kemi edhe ta lexojmë ne. Mos ta marrim vetëm gojarisht nga kryetari, edhe atë ditën e seancës. Ju kisha lut që në

seancën e ardhshme – ishalla nuk ndodh më që vendimet të cilat i marrim të na kthehen prapë, po nëse na kthehen, të na dërgohet edhe arsyetimi i Ministrisë. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Shpetim! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Kalojmë te pika e katërt: Vendimi për rishqyrtimin e Vendimit për rialokimin e mjeteve të buxhetit 2023-2024. A do dikush me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, edhe kjo pikë ishte propozim i imi që të futet jashtë radhës si pikë e veçantë. Propozim-vendimi për rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.060/01-8519/5/24 për rialokimin e mjeteve të buxhetit nga viti 2023 në vitin 2024. Unë edhe një herë thashë, ky vendim është kthye i ligjshëm nga ana e Ministrisë. Po e lexoj: Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Dragashit është në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të Departamentit të Buxhetit. Atë ditë kur e keni votue ju, janë votue disa projekte. Unë po i lexoj: Asfaltimi i rrugës Kuklibeg-Bjeshkë; Ndërtimi i Urës në Qollopek; Kubëzimi i rrugës në fshatin Plavë; Ndërtimi i Impiantit në fshatin Brezne; Kubëzimi i rrugëve në fshatin Rrenc; dhe ndërtimi i Ujësjellësit në fshatin Kukajan. Këto projekte nuk janë ndryshue, i ka pranue Ministria. Ndërsa: Ndërtimi i pllakës së kulmit – ashtu quhet projekti – në shkollën “28 Nëntori” në Bresanë, në vlerë 21,744.50; Asfaltimi i rrugës Dragash-Stadion – 27 mijë, këto mjete Departamenti i Buxhetit nuk lejon që njëra të shkojë në arsim e tjetra në kulturë, por thotë që nëse doni me i rialokue, duhet të shkojnë në Drejtoratin e Urbanizmit. Ne si Qeveri Komunale, të dy këto projekte i kemi bashkue, në vlerë prej 49,047.48 euro, i kemi qit te “Ndërtimi i rrugëve në qytezën e Dragashit, Rruga “Sheshi i Dëshmorëve”, Rruga Unazore në Dragash”. Këto mjete do të qiten këtë vit, për me u punue këtë vit këto ndërtime në vlerë 49 mijë. Andaj, edhe ju si delegatë duhet të votoni vetëm për këto mjete. Ishte edhe propozimi që këto mjete të shkojnë diku tjetër, mirëpo ne si Qeveri Komunale i kemi parapa që këto mjete të shkojnë në projektin e përbashkët në Dragash. Faleminderit!

Driton Ademi: Kryetar, edhe në fillim të seancës ta thashë, edhe tash, unë u mundova me e lexue qetu që e ka kthye Vendimin Ministria. Tip o thuesh me u kthye te Drejtoria e Urbanizmit qeto pare. Domethënë, projekti nuk munden me u ndryshue me destinim tjetër. Në muajin mars, ky e ka pas planifikimin për tjetër send. Në prill e ka pru për pllakën edhe kulmin, ia ka ndërrue kodin buxhetor në prill. Tash, pse prej marsit në prill e ka ndërrue kodin buxhetor, pse tash nuk po mundkan me u ndërrue. Prapë janë paret në Komunë, nuk janë t’u dalë jashtë Komunës. Nuk është puna që janë në Bresanë, po po due me thënë janë në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit. Drejtoria e Urbanizmit munden me i shpërnda ato pare dhe në lokalitetin ku është në Bresanë, sikur te qeky projekti ose te projekti tjetër që është. Edhe më e rëndësishme, nëse ndahen këto mjete, me u nda te mbledhja e ujërave atmosferikë, ashtu qysh janë duke e kërkuar banorët. Nëse ka mundësi me u bo këtu. Pres një sqarim!

Nedžmidin Sejdlar: I nderuar Kryetar, e kam lexuar me kujdes këtë dokument dhe na është kthyer nga seanca e kaluar. Për aq kohë sa më shërben kujtesa. Ne votuam të njëjtën seancën e kaluar. Disa prej nesh kundërshtuan, shumica jo, por bëhet fjalë për të njëjtin dokument. Epo atëherë e kam gabim, mirëpo kryetar, më duhet t’ju pyes, banorët e fshatit Rapçë po ju pyesin pse po i merrni 3000 euro ujësjellësit. Në këtë dokument, neni dy thotë. Nga ujësjellësi po i merrni 3000 euro banorëve të fshatit Rapçë. Planifikove për ujësjellës, për të ndërtuar një ujësjellës, për të rehabilituar atje, e morët, investoni në disa aktivitete të tjera. Vendasit më pyesin pse po ua heq ato para se unë e kam hetuar çështjen e atij ujësjellësi, herën e fundit që ke thënë se ka përfunduar, njerëzit thonë se nuk është. Mendoj se do të ishte e dobishme t’i kushtoni vëmendje atij ujësjellësi në fshat, sepse qeveria e kaluar është një nga arsyet pse ata e lanë, ndër të tjera, atë ujësjellës. Tjetër gje zoti kryetar ju po i nerrni

17373 euro asfaltimit të rruges Zlipotok-Backe-Globoçica-Brod, e di që do thoni tani, kemi 360.000, mbarojme, pse nuk i zhvendosim fondet ku ato ishin të destinuara. E treta, Kryetar, ju merrni edhe 18785 euro dhe 50 cent nga banorët e fshatit Rapça, të destinuara për parkim dhe park. Dhe pastaj investoni në asfalt në Dragash, në drejtim të stadiumit, në rrugët për në Dragash. Pse po ua heqim këto para fshatarëve, nëse nuk i kemi përfunduar ato projekte, pra nëse ju si autoritet ekzekutiv nuk i keni përfunduar ato projekte dhe po i zhvendosni në diçka krejtësisht tjetër. E vetmja gjë që me pelqen ketu është që do të marresh 24000 euro nga Behari, për blerje automjetesh, se ne e dime se çfare automjetesh blen Behari. Të cilat vetëm zbresin, sipas Zhurit, nuk do të ngjiten, ndaloni, ndaj ju kërkoj zoti Kryetar të më jepni një përgjigje të detajuar, sepse heqjen e këtyre fondeve e shoh si diskriminim ndaj komunitetit tim, jo ndarje. qoftë njërin apo tjetrin komunitet në rajonin tim. Dhe sinqerisht më intereson se si do ta mbështesin këtë synim tuajin kolegët këshilltarë nga Gora. Sepse nuk e shoh qëllimin se çfare do të bëjme ketu nëse na hiqen parate që na dedikohen si te doni ju.

Shpetim Hajredini: I nderuar kryetar, po lidhem direkt dhe po e lexoj vetëm këtë Vendimin dhe arsyetimin të cilin e keni shënue ju, për sqarim për ne që ka qenë, se çka ka ndodhur nga ana e Ministrisë, për ralokimin e mjeteve vetanake, edhe çka ka thënë këtu. Pasi që është kthyer si i ligjshëm ky Vendim nga Ministria e Financave, mirëpo zyrtarja nga MF-ja nuk po pranon që të rialokohen këto mjete, atëherë duhet që të rishqyrtohet ky Vendim. Kush është kjo zyrtare, kryetar? Nëse Ministria e kthen të ligjshëm, kush është kjo zyrtare që është mbi ligjin? Dhe, pse keni bërë ndryshim, pastaj? A i bjer kjo që ka qenë ndesh diku me ligjin? Tash është rikthye dhe është ndryshue. Po mos të kish qenë ndesh me ligjin, do të kishim vazhdue prapë njëjtë dhe e kishim votue sot. Nuk ka njeri apo ministra – kushdo qoftë ajo – që mund të jetë mbi ligjin. Ligji është mbi të gjithë, prandaj edhe ky Vendim ka qenë ndesh diku me ligjin. Pasi që kjo zyrtare na ka kthye edhe një herë në rishqyrtim dhe ndryshim. Besoj se të gjithë e vërejmë se çka ka ndodhë, ti vetë e potencove, që është bërë bartja nga Arsimi tek Urbanizmi. Këtu ka qenë po më duket ai lëshimi që është bërë nga ana jonë, në Vendimin e mëhershëm të cilin e kemi bo në seancën e kaluar. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Diskriminim në baza nacionale unë nuk mund të bëj, se jam kryetar i të gjithëve. Diskutimet të cilat nxitin urrejtje, nuk duhet të kenë vend në Kuvend këtu. Ju i përmendet gjoja se i është marrë dikujt, e i është dhënë dikujt. Ndarjen proporcionale na e kemi bo më shumë se 41.3%, dhe nëse i është marrë diku 3000, i është dhënë Kukajanit 14,000. Tash po i merren Bresanës, po çohen në një projekt për investime të përbashkëta. Këto nuk duhet të shiqohen ashtu siç tha edhe delegati parafolës, dhe duhet gjithsesi ne të punojmë që të unifikohemi edhe të mos nxitim urrejtje ndërnacionale. Dikujt kjo i konvenon, por mu nuk më konvenon edhe unë do të punoj që këso urrejtje të mos ketë edhe të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit të jenë të barabartë para ligjit. Sa i përket pyetjes së Shpetimit, unë e lexova Vendimin, por ma poshtë shkruan që të bashkëpunojë ngushtë me zyrtaren e Buxhetit. Unë kam pas dy telefonata me zyrtaren e Buxhetit – s'ka nevojë me ia përmend emrin – edhe këto mjete për mos me i humb, ne kemi marrë këtë Vendim edhe këto mjete po i marrim nga këto dy projekte, po i qesim në një projekt të përbashkët për Dragash. Është mirë ju si delegatë që ta votoni, zgjidhje tjetër nuk ka. Faleminderit! Askujt nuk ia përmenda emrin, përveç Shpetimit!

Arijeta Skeraj: Nežmidin Sejdilar, nuk t'u përmend emri! Kështu që, ti po duesh që unë t'i përmbahem Rregullores, atëherë, me Rregullore, pa t'u përmend emri nuk ke të drejtë ta marrësh fjalën. A ka diskutime tjera? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 15 vota pro, 1 kundër edhe 1 abstenim, e miratojmë këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e pestë: Vendimi për zgjatjen e afatit ose formimin e Komisionit për zgjedhjen e

drejtorëve të shkollave. A ka diskutime këtu? z.Jetmir, drejtori ke ma herët këtu edhe e sqaroi këtë pikë. A do dikush me diskutue?

Jetmir Ajdini: E lus drejtorin e Arsimit që të del të na sqarojë të gjithëve këtu, çfarë saktësisht po kërkon, a don me ia shty afatin këtij Komisioni, a do me formue Komision të ri, apo ku është esenca e këtij diskutimi. Edhe të gjitha sqarimet, qe sa kohë është ai Komision pa afat? Faleminderit!

Nexhat Selaj: Ndoshta po më vjen se si i tepërt që po flas pak për arsimin, por i takoj kësaj fushës edhe due që të flas. Që në seancat paraprake edhe pak më parë t'u drejtova, z.drejtor, po kur nuk po ke njohuri të mjaftueshme nuk dalish këtu, kur ke njohuri dalish t'i flasësh dy fjalë. Unë para seancës së parë ose të dytë, kam kërkuar, pak më parë thashë, ke dalë mbrapa kamerave jashtë, s'ke pas guximin me dalë këtu, drejtor i Administratës po më duket ka dalë e ka dhënë një përgjigje. Kur janë emëruar fillimisht, ka qenë gabim, kanë qenë të kundërligjshëm. Pse kanë qenë të kundërligjshëm? Nga vetë Drejtorati i DKA-së, që e ke pas personin në fjalë akoma aty, i ka qenë i përzgjedhur gabimisht, ai ka qenë në monitorim, e jo që të është përzgjedhës. E dyta: Si mund ne tash, të njëjtin gabim prapë ta përsërisim, t'i vazhdojmë? Nëse i skadon kontrata, afati, nuk ka të drejtë edhe një herë të konkurrojë. Tash gabimin e dytë po e bëjmë. Shiqone edhe një herë ligjin, rregullone edhe një herë, merrnu me ligjin, edhe dilni këtu. Mos na bini para një akti të kryer, tek ne asambleistët! Ju numrat po i keni, po e votoni, kur po vjen seanca tjetër, me e kthye prapë. Kështu po na ngjan disa herë, nuk është hera e parë. Është e kundërligjshme që të vazhdohet kontrata ose afati i këtyre përzgjedhësve. Faleminderit!

Driton Ademi: Atëherë, pak po lidhem të Udhëzimi Administrativ, kemi bisedue edhe vjet, Udhëzimi Administrativ ka qenë për një vit shkollor, jo për një vit kalendarik. Më së pari, zyrtari që është në DKA nuk e ka pas plotësimin e kushteve për me qenë në Komision, si pikë e parë. Si pikë e dytë, me UA, përzgjedhjen e drejtorëve që e kanë bo – mos gabofsha – në nëntor ose dhjetor, ai Komision nuk ka pas afat për me i zgjedhë drejtorët. I ka dalë afati atij Komisioni më 31 gusht 2023. Kështu që, drejtorët janë në kontekst me Komisionin edhe me zgjedhjen si drejtor ata, se na po dona me ia shty. Me UA, me sa e pashë unë – s'un e lexova krejt, po nuk e di a ju lejohet për me e shty këtë Komision. Edhe nëse e bëjmë, pse ne nuk po e marrim një vendim me na pru në seancë të gushtit, për me e marrë për një vit kalendarik për gushtin e 2025-tës, që me e pas Komisionin të përgatitur. Se na edhe vjet kemi formue Komision, në prill ose në maj, vetëm për 3-4 muaj. Është ma mirë me e planifikue me kohë, që ky Komision të zgjidhet ose në korrik, ose në gusht, që ta ka mandatin prej 1 shtatorit deri më 30 gusht të vitit të ardhshëm. Unë po mendoj që është propozimi shumë më i mirë kështu, na me e shty ma tutje, për në seancën e korrikut ose të gushtit, edhe me formue Komision të ri, jo me ia vazhdue mandatin këtyre. Faleminderit!

Zeni Krasniqi: I nderuar delegat, pyete se a ka pas kontest në përzgjedhjen e drejtorëve, unë e di se procedura ka qenë shumë e rregullt, gjë që e ka pranuar edhe MASHTI, e cila e ka pas edhe përfaqësuesin e vet. Unë një sqarim po ju jap, unë kërkoja që t'i vazhdohet këtij, po unë po dal tash me një propozim të ri, që të formoni Komisionin e ri me këtë propozim, e lejon edhe ligji: Një përfaqësues nga DKA-ja si kryesues; një ekspert i pavarur i arsimit; dhe anëtar i tretë le të jetë nga MASHTI. Le të jenë ata anëtarë që kanë ekzistue pak më herët, e juaja është tash, i votoni, e formoni apo nuk e formoni.

Shpetim Hajredini: I nderuar drejtor i Arsimit, ne e votuam një propozim të juajin në fillim të seancës, për vazhdim thajë të këtij Komisionit. Tash e ndryshove, a po e votojmë prapë edhe njëherë, po i emërojmë anëtarët e ri? A po ia vazhdojmë anëtarëve të Komisionit të mëhershëm, apo anëtarët e ri? Cilën po e bëjmë, ta dimë saktë edhe po vendosim. S'është në rregull, këto gjëra duhet t'i keni parasysh para se me ardhë në seancë, dhe jo me na i ndryshue. Po për mu, realisht, nuk është befasi. Por, ne jemi

këtu për të mirën e qytetarëve, dhe le të vendosin cilin po e mbajnë, a po e mbajnë vazhdimin e këtyre personave që i kanë pas ma herët, apo po i ndryshojnë emrat. Nëse i ndryshojnë, po e votojmë. Kryesore, mos të jemi veç kundër ligjit.

Arijeta Skeraj: Atëherë, Shpetim Hajredini kërkoi nga drejtori i Arsimit që a do të vazhdohet apo do të bëhet tjetër Komision.

Zeni Krasniqi: Unë nuk e di sa isha i qartë, ishte për me u aprovue rendi i ditës, ne kërkua që të futet në rendin e ditës kjo, si shtyrje. Me e shqyrtue si pikë të rendit të ditës. Tash ju – unë i dhashë propozimet, mund ta votoni Komisionin e ri edhe gjithçka është në rregull, besoj. Delegatë, ju propozimin tim që thashë me e vazhdue nuk e votuat. Vetëm kërkova unë që të futet në rend të ditës. Tash është në radhë pika e rendit të ditës, propozova Komisionin e ri, urdhëroni votone, ose mos e votoni!

Arijeta Skeraj: Drejtori, për me e fut në rend të ditës, ka kërkuar që të vazhdohet ky Komision. Atëherë, fjalën e keni ju! Shpetimi e ceki, nëse është për me e vazhdue, edhe në qoftë se është për me e bo Komisionin e ri.

Nedžmidin Sejdilar: Për mua është vërtet e paqartë nëse do të zgjedhim anëtarë të rinj të komisionit apo do t'ua zgjasim mandatin anëtarëve tashmë të skaduar të komisionit. Sepse në fillim të kësaj seance, siç kuptova, drejtori kërkoi që të fusim një pikë në rendin e ditës për të zgjatur mandatin e këtij komisioni aktual. Të paktën kështu e kuptova. Në gjuhën shqipe origjinale, për shkak se nuk e përdor përkthimin, nuk mund të them që përkthyesit përkthejnë dobët. Diçka tjetër, zonja kryetare, dua t'ju lus ta lexoni rregulloren e Kuvendit, sepse padyshim që nuk e keni lexuar. Lexo nenin 10 ku thote se cdo delegat ka te drejte 10 minuta prezantim dhe + dy minuta nese ka dicka per te shtuar apo pyetur, pak me pare me diskriminove me dashje, me hoqe te drejten e fjales.

Nexhat Selaj: Drejtor, nëse e ke para vetes Udhëzimin Administrativ, shfletuje! UA Nr.151/2020. Ke durim, se unë nuk flas pa fakte. Unë po ta lexoj, e ju përcillne, edhe kolegët mund ta përcjellin. Sipas UA 151/2020, Neni 177 thotë: Deklaratën nën betim që vërteton se tri vitet e fundit kandidatja apo kandidati nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturën partiake politike. Thaje drejtorët nuk janë politikë edhe nuk e kanë shkelë ligjin. Ne akoma kemi pas këtu aambleist, kur ai ka qenë – e keni përzgjedhë si drejtor, prej postit të Asamblesë ka shkue është emëruë drejtor. Ju thoni nuk e kemi thye ligjin edhe jemi me ligjin. Po s'ke durim edhe me dëgjue, se nuk ke përgatitje për këtë punë. S'je kërkund, ke hup krejt. Del e flet dy minuta edhe thotë a po më dëgjosh. Unë nuk e di sa më dëgjove ti! E ke ligjin para vetit, e ken Nenin, shikoje! Po ta ceki edhe një herë, se ishe duke marrë instruksione prej kryetarit. Deklaratën nën betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati ose kandidatja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturën partiake politke. Ju e keni zgjedhë drejtor nga vendi që ka qenë asambleist. Si mund të mos jetë kundër ligjit kjo? Urdhëro e del këtu, foltorja është për ju, nuk është për mu. Ne si delegatë jemi të detyruar të pyesim, ju si ekzekutiv të jepni përgjigje. Urdhëro, del jep përgjigje! Mos thuaj se nuk kemi bo përzgjedhjen e drejtorëve në mënyrë të paligjshme. Të dy drejtorët të cilët janë zgjedhë kanë qenë të paligjshëm, plus edhe Komisioni ka qenë i paligjshëm. Që nga koha e parë kemi deklaruar, ju kemi thënë se janë të paligjshëm, keni vazhduar, tash prapë po detyroni, po na kërkoni lutje që t'i mbështesim. Po si mund ta mbështesim ne një vendim i cili është jo i ligjshëm? Urdhëro del, merre ligjin! Nëse ke naj ligj tjetër, na trego, se ne nuk i dimë. Ne po bazohemi te 151/2020.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A ka sqarime prej ekzekutivit?

Bexhet Xheladini: Përzgjedhja e drejtorëve ka përfundue, afatet ligjore për ankesa kanë përfundue. Sa i përket asaj që është zgjedhë drejtori i cili ka qenë asambleist, pozita e asambleistit nuk është pozitë politike, ai është i zgjedhur i popullit, është votue, edhe nuk është pozitë udhëheqëse në parti. Aty shkruan në ligj: nëse ka pozitë udhëheqëse në parti. Asambleisti nuk është pozitë udhëheqëse në parti. Ai është i zgjedhur i popullit, kështu që kjo është përgjigjja e saktë që mund ta them, sa i përket pyetjes që e ka bërë delegati. Drejtorët janë përzgjedhë, janë emërue, janë duke punue, afatet ligjore për ankesa kanë kalue. Keni mund me u ankue edhe organet gjyqësore me u marrë me këtë çështje. Unë jam kryetar i Komunës edhe unë për atë i emëroj drejtorët, të lëmive të ndryshme, si ekspertë të cilët edhe i konsultoj. Për pikën e rendit të ditës që e propozoi drejtori i Arsimit, unë kam të drejtë me të me u konsultue. Unë jam me profesion mjek edhe mora sqarime të nevojshme prej tij, për këtë propozim që e ka dhënë. Andaj, e kisha lut drejtorin, le të dalë edhe një herë, këto paqartësi që u bënë le t'i sqarojë, edhe shkojmë më tutje. Faleminderit!

Driton Ademi: Edhe një herë me ia sqarue, se s'e di a e ka lexue drejtori, te Neni 6, Pika 9: Komisioni përzgjedhës cakton për një konkurs, domethënë një konkurs ka me qenë Komisioni, brenda këtij viti. Komisioni për një konkurs ka me qenë. Brenda një viti. Për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës, me propozim të DKA-së, anëtarët e Komisionit nga DKA mund të caktohen nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor. Siç ta thashë herën e parë, nga 1 shtatori deri më 30 gusht të vitit shkollor. E ke edhe në UA, Neni 6, Pika 9. Është mirë me e lexue edhe është mirë sot mos me u gut – unë s'e di a e keni ndonjë drejtor pa emërue e doni me emërue shumë shpejt. Veç qekjo si të ndodhë, unë ju thashë, e keni mënyrën më të mirë me e shty edhe në qershor, ose në korrik, me e afrue vitin shkollor, me e pas mandatin tamam. Po ju po doni tash... po unë nuk po shoh këtu që mundeni me ia shty afatin këtij Komisioni, siç thajë në fillim të seancës.

Zeni Krasniqi: Unë kërkova që t'i vazhdohet afati këtij Komisioni, unë prapë propozoj, nëse si Komision i ri votohet këtu, atëherë unë i jap emrat. I pari do të jetë Faton Nafezi – përfaqësues nga DKA si kryesues, Fatmir Mehmeti si ekspert i pavarur i arsimit, dhe anëtari i tretë vjen nga MASHTI.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! Ju kisha lut, delegatë të nderuar, të gjithë ishit në sallë, i dëgjuat emrat, e dëgjuat çka tha drejtori, edhe një herë po kërkoni masi po e qes në votim, edhe po e merrni fjalën. Ju kisha lut! Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Deri tash – Artan – e ke pa diskutimin e drejtorit, nuk e ke kuptue, del merre fjalën edhe mos më thuaj masi ta qes në votim. Hera e fundit, këtë më nuk e lejoj! Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryesuese, mos ma jep fjalën, po unë nuk e kuptova, nuk e kam për inat. Prapë po them, s'po munda me e kuptue, një herë ka kërkue me e shty, tash po kërkon një Komision të ri, i dha emrat. Udhëzimi Administrativ po të kallxon që prej 1 shtatorit deri më 31 gusht. Po e votojmë na Komisionin, prej cilës datë do të jetë legjitim ky Komision deri më cilën datë? Prej cilit, a prej sot, a prej 1 shtatorit? Se në qoftë se votojmë sot, deri më 31 gusht duhet ky Komision me qenë legjitim. Këtu është problemi. Edhe, unë nuk e pata me qëllim të keq, nuk e kuptova edhe kam qef me e kuptue unë edhe të gjithë qytetarët.

Driton Ademi: Drejtor, edhe vitin e kaluar ta kam thënë që është një vit kalendarik, edhe sot po të them. Vjet të kam thënë që ke afat deri më 30 gusht, edhe i keni zgjedhë drejtorët edhe mas asaj. Ankesa që s'kemi bo, është vërejtje e jona, ajo është çështje e politikës. Por ti, nëse sot e formosh këtë Komision, Ministria ta aprovon. Nëse ta aprovon Ministria, qeky Komision ka afat deri në fund të gushtit. Atëherë, ti mas gushtit nuk mundesh me veprue. Unë kërkova, si propozim e thashë, mundesh ose në korrik ose në gusht. A nëse e ke qaq zor të madh që të ka thënë deni drejtor për me bo tash në qershor, mundesh me e bo. Po ma e mira është me e pru në seancën e korrikut ose të gushtit edhe e ka një vit kalendarik

ky Komision. Por, prapë ju vetë e dini. Vit shkollor e kam fjalën. Nëse e formojmë sot, dije që e ke deri në fund të gushtit këtë Komision. Atëherë duhet me formue Komision të ri, prej shtatorit deri në gushtin e ardhshëm. Faleminderit!

Uran Halimi: Të nderum delegatë, është e vetëkuptueshme dhe shumë e logjikshme, meqenëse nuk ka Komision, edhe i ka skadue afati këtij, ky Komisioni të cilin e propozoi drejtori i DKA-së, ka mandate deri më 31 gusht. Atëherë, në verë ne mundim me e rizgjedhë një Komision që e ka një vit të plotë shkollor, prej shtatorit në gushtin e ardhshëm 2025. Ne po votojmë për një Komision që ka mandat deri në fund të gushtit. Qashtu e sheh ligji, se për një viti shkollor është në pyetje. Faleminderit shumë!

Shpetim Hajredini: Më pëlqej fjalimi i Uranit, po nuk e mora atë përgjigjen të cilën pata dëshirë ta marrë unë. Ne të gjithë po diskutojmë se sa periudhë kohore ka të drejtë ky Komision të funksionojë, por nuk e diskutuam çëshjen se – për shembull unë e di realisht që në momentin që MAPL-ja e merr si të ligjshëm, ai Komision duhet të jetë valid. Po a ka mundësi na sot, për shembull, nëse e votojmë sot këtë Komision, dhe të hyjë në fuqi, për shembull në gusht. Vetëm desha me e marrë nga dikush që ka të bëjë me ligjin dhe që e kupton ligjin. Se ne sot nëse marrim vendim, atëherë në bazë të UA, po tregon që po i bjer 3-4 muaj që është i ligjshëm ky Komision dhe pastaj përfundon validiteti, duhet edhe një herë ta votojmë Komisionin. Nëse nuk e keni me urgjencë, pse atëherë sot ne po e votojmë, po e lëmë në shtator. Nëse e keni me urgjencë dhe duhet patjetër që sot ta votojmë, atëherë po e votojmë sot edhe në shtator prapë e votojmë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 11 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë kalojm te pika e fundit, pika eventuale. Para se me e marrë asambleistët fjalën, unë do ta marr vetë. Ne si Asamble Komunale dhe si organ vendimmarrës, e kemi për obligim ligjor që t'i përcjellim punët e ekzekutivit. Kërkesa e asambleistit Nedžmidin Sejdlar për shikimin e automjeteve të QKMF-së, më ka ftuar mua që këtë ta marr seriozisht. Unë e mbështes këtë që ma ka kërkuar z.Sejdlar, dhe i kisha lut të gjithë shefat e grupeve ose të gjithë Asamblenë, që ne të gjithë mundim me shkue me i kqyr të gjitha automjetet e QKMF-së, për arsye se ato në qoftë se nuk janë funksionale, atëherë na dëmtohet buxheti i të afërmve dhe qytetarëve tanë. Atëherë, e kisha lut drejtorin e Administratës që është kompetent për këto automjete, që të na japë një sqarim, për arsye se kjo m'u bë kërkesë mua si kryesuese e Kuvendit. Këtë e kam marrë shumë me shqetësim, për arsye se edhe unë dua që ato autoambulanta të jenë në gjendje shumë të mirë. Faleminderit!

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesuese! Të nderuar asambleistë, meqenëse ne si Drejtori e Administratës – edhe këtu salla e Asamblesë Komunale shpeshherë ka hasur në diskutime dhe ngritje të çështjes se automjetet që gjenden në shërbim në QKMF nuk janë në gjendje të mirë teknike. Ne si Drejtori, përkatësisht unë si drejtor i Administratës, meqenëse mbaj edhe përgjegjësinë mbi supe për gjendjen e tyre teknike dhe servisimin e tyre, këroj nga ju si kryesuese, nga shefat e grupeve të të gjitha partive politike, dhe nga të gjithë asambleistët, si të dërguar direkt të qytetarëve, dhe nga drejtorët, dhe po ashtu edhe mediat, që të na shoqëroni mua dhe kryetarin në hyrje të Komunës, ku pas pak çastesh, brenda dy-tre minutash, do të defilojnë të gjitha automjetet, autoambulancat e QKMF-së në Dragash dhe të qendrave të tjera. Duhet theksuar se ky Vendim është marrë me qëllimin e vetëm që të demantohet një herë e mirë e pavërteta e madhe që i është servue qytetarëve të Komunës sonë. Një e pavërtetë e cila luan me gjënë më të vlefshme të qytetarëve: shëndetin publik. Nuk është mirë që të gënjehet për situatën që gjendet në QKMF, një qendër ku të gjithë banorët e Komunës sonë marrin shërbime çdo ditë dhe nga më të ndryshmet. Po ashtu, më lejoni që paraprakisht t'ju sqaroj se nga tetë automjete të cilat gjenden në pronësi të Drejtorisë së Shëndetësisë, përkatësisht në menaxhim të

QKMF-Dragash, dy autoambulanca nuk do të defilajnë këtu, për arsye se, me qëllim që të mos rrezikojmë shëndetin publik dhe terreni jonë është i hapur, një autoambulancë e kemi lënë në kujdestari në fshatin më të largët të regjionit të Gorës, në Restelicë, dhe një tjetër në fshatin Brodosanë, fshatin thuajse më të largët apo në qendrën e fundit të mjekësisë familjare që qëndron në trevën e Opojës. Një tjetër autoambulancë për momentin gjendet në shërbim në Prishtinë, meqenëse një zyrtar i Laboratorit sot kthehet nga Spitali, përkatësisht zyrtari Bajro Bajrami, që pardje ka pësuar një sulm. Kështu që, ju lus të gjithëve që të na shoqëroni, do t'i testojmë të gjitha autoambulanat, fillimisht do të ndalet autoambulanca, do ta shiqojmë gjendjen e tyre optike dhe teknike, do t'i pyesim a kanë oksigjen, a kanë defibrilator, si është gjendja e shtratit brenda autoambulancës, a i funksionon sistemi i dritave rotative, dhe a i funksionon sistemi i alarmit. Kështu që, nëse e kam pëlqimin tuaj, kryesuese, edhe të Asamblesë, ju lus që të na shoqëroni. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! Pasi që Nedžmidin Sejdilar e ka kërkuar këtë nga unë, dhe unë e kam marrë shumë me dëshirë këtë që e ka bo dhe shumë e kam përkrah dhe e kam lut ekzekutivin që këto ambulanta të sillen një herë e përgjithmonë dhe t'i shohin të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit, për arsye se jam ndie shumë keq pasi që shumë udhë e largët është, diku 36 km të udhëtojë një pacient prej Komunës së Dragashit në Prizren, pa oksigjen. Kjo na përket neve, në petkun e asambleistit që na kanë pru këtu. Atëherë, ju kisha lut të gjithë shefave të grupit dhe të gjithë Asamblesë që t'i shikojmë vetë me sytë tanë, për së afërmi, një herë e përgjithmonë të mbyllet kjo çështje që u diskutua shumë herë në Komunë.

Shpetim Hajredini: Unë personalisht, po edhe si shef i Grupit të partisë më të madhe në Kuvendin e Dragashit, nuk e kam ngrit asnjëherë këtë çështje të cilën sot po diskutohet nga ana e ekzekutivit dhe po na kërkohet që të shkojmë autoambulanat. Unë nuk do të marr pjesë, se nuk jam mekanik, nuk marr vesh a punon apo nuk punon. Është e mira e kësaj që të funksionojnë të gjitha, për të mirën e qytetarëve dhe t'u ofronë shërbimin e duhur, shërbimin i cili duhet të kryhet nga ky automjet. Prandaj, nëse janë funksionalë, është në rregull, nëse nuk janë funksionalë, keni marrëveshje, keni kontratë me mekanika, shkoni rregulloni, i kryni edhe le të kryejnë shërbimin i cili është i duhur. Ju faleminderit për ftesën, por unë personalisht nuk marr pjesë! Nuk kam nevojë të marr pjesë! Kaq!

Nedžmidin Sejdilar: Ju falenderoj edhe pse sot u inatoso pak me ju, por meqe keni nisur hapat për keto mjete do jua shoh pak ne gishta. Për t'u sqaruar, nuk kam kërkuar të shoh automjetet e qendrës së mjekësisë familjare, por kam kërkuar të shoh pesë automjete të blera nga viti 2021 dhe 2022.

Konkretisht më intereson të shoh ato pesë automjete që kanë paguar qytetarët e kësaj komune, sepse vetë zoti Brenoli në raportin e tij për vitin 2021 dhe 2022, që e kemi diskutuar këtu në kuvend, se ka blerë gjithsej pesë automjete me të plota pajisje mjekësore. Këto ishin fjalët e tij, dua të shoh ato pesë automjete që nuk janë më të vjetra se 2021. Zoti Ramadani, unë nuk luaj me shëndetin publik dhe kujdesem sa më shumë për të. Kolegu juaj Brenoli tha në këtë altoparlant, do të përpiqem ta citoj, automjeti Citroën ka problem, a fiket kur aktivizohet karburanti, sensori, por nëse e ndizni përsëri funksionon. Dhe tha se nuk është problem kur shkon drejt Prizrenit, por kur kthehet në drejtim të Zhurit, nga kjo foltore. Ka regjistruar me tekst dhe video. Ka video të dhëna për këtë dhe unë ende insistoj dhe ju kërkoj që t'i shihni të pesë ato automjete, të shihni se në cilin vit janë prodhuar, si janë blerë me tender dhe cili komision i ka marrë ato automjete dhe çfarë pajisje mjekësore kanë brenda. , dhe unë jam ende duke kërkuar dhe dua dhe dua ta shoh. Zoti kryetar bashkie po nxisni urrejtje kombëtare. Dje i komentuat një drejtuesi, një përfaqësuesi të popullit, një ish-koleg i yni që kishte tre mandate këtu, u ul në atë karrige këtu. Ti i ke thënë se është një burrë i ligët, është Velid Haxhisin. Ti nga profili yt ne facebook, nese i sjell vetes luksin te ulesh postin e kryetarit dhe t'i thuash ish

keshilltarit se eshte ligë, atehere kush nxit urrejtje kombetare une apo ti, pavaresisht se me pergjigjesh apo jo, nuk eshte dhe aq e rendesishme, e treta zoti kryetar, edhe pse Arijeta Skeraj si kryetare e kuvendit me ndaloj t'ju pergjigjem, une do ta perdor kete te drejte ne kete pike dhe do t'ju them keto, ju u mburruat se ke marrë para nga një projekt dhe ia ke dhënë fshatit Kukuljanë. Ti i ke marrë Rapqës rreth 22 mijë euro dhe i ke dhënë Kukuljanit 14 mijë euro. Rruga Zlipotok-Krushevë-Globioçicë-Brod ka marrë 17 mijë euro. Epo, mua më intereson matematika proporcionale, nëse zbresësh rreth 50 dhe disa mijëra euro, merr 14, është 41% kundrejt 59%. Ose matematika ime është e gabuar. Ndoshta më kanë humbur formulat. Gjëja e tretë, e cila është shumë e rëndësishme, zoti kryetar, ju nuk mund t'i bëni këto gjëra nëse nuk do të kishit satelitët tanë këtu. Delegat nga JGP qe te mbeshtesin ne keto zhatje, po nuk i ke keta delegat prezente renegati Vakatit, tash jane SDU, nuk e di cfare jane, se nuk te perkrahin, jane ketu te ngre dorën si i thua dhe ata janë për mua dhe për të gjithë njerëzit në Gorë që mendojnë si unë, nuk janë gjë tjetër veçse tradhtarë thjesht. Dhe ata janë aty për të përfunduar punët më të pista që ju vetë keni turp.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, z.Sejdilar! Ndoshta ishte gabim përkthimi, po thaje që Arijetën do ta ledhatoj. Tash kjo fjalë mu, jo që më pengon, por ledhatim kryesueses nuk mundesh t'i thuash!

Nedžmidin Sejdilar: E kuptoj plotësisht që e gjithë qeveria është në panik. Dhe ju, nëse keni problem me përkthyesit, thirrni tenderët që ata t'ju përkthejnë me cilësi të lartë. Fjalët që përmende nuk janë thënë nga unë. Nëse mendoni se unë e thashë këtë zonja Presidente, ju kërkoj falje publike, por nëse nuk e thashë dhe do të kërkoj procesverbalin dhe videon, atëherë duhet të largoni përkthyesit.

Arijeta Skeraj: Jo, do t'i kërkoj falje, në qoftë se e ka bërë përkthyesi, kërkoj falje në qoftë se ai nuk e ka thënë, se unë nuk e di gjuhën, për atë arsye, por më erdh interesant. Ju kisha lut – kryetari i Komunës është i ftuar në OSBE – pyetjen të jenë të shpetja që kryetarin ta lirojmë.

Uran Halimi: Unë po e liroj kryetarin prej pyetjeve, këso heri masi është i zënë – ne jse, gjithë i zënë është kryetari – po sot pak me mirësjellje. Më erdh çudi për veturat, atë çështjen që ju i ngritet, kryesuese, me iniciativën e z.Sejdilar. Më erdh çudi, këtu përgjigje po jep drejtori i Administratës për veturat e Drejtorisë së Shëndetësisë. S'po e di qetash, i keni përzie goxha rolet ju drejtorët, ju superdrejtorët sidomos. Është mirë me dhënë përgjigje drejtori i atij dikasteri të cilit i përket, po s'është problem. Na me i shique ato veturat, m'u dok pak si qesharake, çka kemi me i shique na veturat? Aty ka dyshime për keqpërdorime, unë qysh e mora vesh. Se s'është në pyetje veç a janë në rregull veturat apo jo. Edhe, është mirë na me e formue një komision hetimor, jo me e bo një sfilatë aty nëpër komunë, se çka marrim vesh na, ato ecin edhe në ler qaty nëpër komunë. Është mirë na me e bo një komision hetimor edhe me e hulumtue secilën veturë, a është e pajisur, qysh ka ardhë deri te blerja e asaj veturës, janë ndarë fonde e fonde. Unë propozoj – znj.kryesuese – që me u formue një komision hetimor. Kemi këtu goxha infermierë, që e dinë cilat janë pajisjet që duhet me u pajis një veturë e ndihmës së shpejtë. Një çështje tjetër që lidhet pak edhe me ju, znj.Kryesuese, është që dje bëra kërkesë për listat e nënshkrimeve, nashta e dish. Jo edhe pa qëllim, po edhe e keni obligim me na i sjellë ato. E hasa që në muajin mars, znj.Xhemile Misinaj nuk ka prezantue fare as në Komitet, e as në seancë, ndërsa pagesa në vlerë diku 700 euro i është ekzekutuar. A jeni në dijeni për këtë apo jo, unë nuk e di, apo ta kanë bërë me qëllim kjo pjesa tjetër e ekzekutivit, mirëpo këto nuk bën me i lejue. Arsyeya pse una jam shkarkue tash po del në pah, se po ndihem edhe shpeshherë fajtor, ka pas raste, ka pas njerëz të sëmurë, unë jau kam fshi nënshkrimin e s'iu kam dhënë pagë. Ka qenë rasti i z.Mehmet Spahiu që ka qenë në trajtim mjekësor edhe iu hek paga. Rasti i z.Loshaj që ka ardhë më ka pyet kur e ka pas një rast në familje atje, unë nuk e kam tolerue. Të kusha lut, znj.Kryesuese, nuk bën me e keqpërdorë çdo cep të

kësaj Komune. Këtu po keqpërdoret kudo që po mundet, prej veturave atje, në Kuvend këtu me mëditje, po e shoh edhe numrat qysh po bëhen këtu. Me siguri me nga 700 euro në muaj. Edhe unë isha bo delegat me shkue me jetue diku tjetër, e me e marrë rrogën këtu. Po na jemi bo delegat me mbajt përgjegjësi përpara atyre qytetarëve që ua kemi lyp votat. Nuk lëshohen mëditje këtu pa prezentue delegati. Po më vjen shumë keq, kryesuese, le të na bjer ligjin, nëse i thoë ligji, le të ja japë, s'është problem. Ama ligji nuk thotë mëditje pa prezentue. Hajde rrogë, - ku e di qysh thotë ligji, më falni se s'po e di saktësisht – ama edhe mëditje, nuk është veç paga aty, është edhe mëditja, qytetarët e dinë, 150 euro mëditje për nja 12-13 minuta që je këtu pa prezentue hiç. S'e di – në gjuhën opojare – çfarë yrrneki është qeky.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Uran! Edhe një herë po ju lus, ata që keni pyetje për kryetarin! Në qoftë se nuk keni pyetje, atëherë, kryetar, mundim me të lirue!

Artan Loshaj: Pyetja e parë, kryetar, ishte e DKA-së, që e pyeta për shkollën profesionale atje. Na keni akuzue në 2021-tën në fushatë, edhe ju si kandidat i LDK-së për kryetar Komune, dhe ish-kryetari i LDK-së, në vitin – në kompjuter, se tanë natën kam punue me i nxjerr ato sekuenca – edhe isha-kryetari i LDK-së që ka qenë kandidat për Asamble Komunale, ishte në debat me shefin e grupit tonë, që ka thënë keni shti pare – edhe shumë mirë po më vjen që është këtu – keni thënë që keni shti miliona euro aty, do ta funksionalizojmë, do të hapim drejtime të reja edhe do të marrim staf shtesë. Kjo deri më sot nuk është bërë, besoj se – e dimë sigurt, edhe ne edhe qytetarët – që nuk e bëni, se keni ardhë veç për një mandat. Po nashta po mundohnu, vitin tjetër kur janë zgjedhjet, me e pre një shirit atje. E dyta, kryetar, pata qef, po dje e kemi bërë një debat bukur të mirë ne të dy rreth stadiumit të Dragashit këtu. Po due me ta bo një pyetje edhe për stadionin e fshatit Blaç, që në fillim, në mënyrë urgjente kemi ndarë 50 mijë euro, e keni thënë për dy-tre muaj do ta funksionalizojmë stadionin. Stadionin e keni në gjendje të mjerueshme në Blaç. I keni bërë nja dy-tri foto me drejtorin e Urbanizmit, me këtë bedelin e Bean Hadziasanit, keni bo do foto aty nja dy-tri metre i keni shtrure. Ta kam thënë edhe dje, ato fotot që i keni bo, që po shtrohet bari, është shumë mirë, edhe të përgëzoj në emërt të Klubit “Opoja” edhe në emër të klubeve private, se merrem me atë sport. Por të kam thënë edhe dje, edhe ato dështimet e rrethojave, edhe dështimet e zhveshtores, qitni bre, thuj qe në çfarë gjendje janë edhe deri në zgjedhjet tjera do t'i ndreqim. Me një video e kam këtu, që ke premtue që 50 mijë euro do të investoni. Keni investue 230 mijë euro, 220 mijë euro ka investue PDK-ja, 450 mijë euro. Nuk po të akuzoj ty, po i akuzoj të gjithë ata akterët që kanë qenë deri më sot. 450 mijë euo, të kam thënë edhe herën e parë, po të them edhe sot, San Siro shtrohet me tepih, edhe është 500 mijë euro vlera stadionit. 450 mijë euro keni investue, nuk jeni kërkund, plus Federata e Futbollit po investon. Deri kur do të ndreqet stadioni, zhveshtorja edhe rrethojat? Edhe – po më vjen keq me u kyç me këtë debatin, po masi jam punëtor dhe asambleist – për sfilatën e kerrave, veturave të QKMF-së. S'po due me folë, po anashkalohe pak, se jam vetë punëtor aty, sfilatë para Komunës nuk bëhet bre kryetar. Në qoftë se dona Komision edhe në qoftë se jemi të pajtimit, shkojmë në QKMF. Se sfilatë para Komunës edhe tash me alarma me bo diçka... unë kam qef, se jam vetë punoj në Urgjencë, unë kam qef në çdo kohë, në çdo moment me pas oksigjen, çdo kohë e çdo moment me pas aparatura, edhe me pas staf. E jo veç për 5 minuta a 10 minuta me e bo një fushatë. Herët është fushata, e linin ë 2025-tën.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! Para se me ia dhën fjalën Driton Ademit, unë deshta me u ndërlidhë, kjo sfilat nuk u bo prej ekzekutivit, u bo nga kërkesa ime që e kam bo, që ma ka kërkue Sejdilari edhe unë i kamë dhënë urdhër – jo kërkesë, por urdhër – që të gjitha ambulancat të vijnë para Komunës, me gjithë shefat edhe Asamblenë, një herë e përgjithmonë të mbyllet kjo që nuk ka oksigjen,

nuk është shtrati i mirë, nuk ka alarm. Për atë arsye. Këtu ekzekutivi nuk ka marrë pjesë, përveçse ka qenë kërkesë e imja, por edhe urdhër nga ana ime.

Driton Ademi: Kryetar, vetëm një pyetje e kam, se seancën e kaluar nuk ke qenë, po është mirë nashta me na dhënë përgjigje. Jo, deri në fund s'ke qenë, po kishte qenë shumë mirë – ke drejtori, po nuk pat kohë për përgjigje. Atëherë, siç e dimë, kryetar, për shkak të motit që po priset, prej fshatit Kosavë, Kuk, Kuklibeg, e deri në Zaplluxhe, ky regjion po kemi shumë problem me rrymën. Unë e di që nuk është në kompetencën tënde kjo çështje e rrymës, por e di që e keni një bashkëpunim, një mirëkuptim me KEDS-in. Nëse ka mundësi, një zgjidhje sa më të mirë me na ofru, megjithëse regjionet tjera e kanë një zgjidhje pak më të mirë, ne po kemi shumë problem kur po ka të reshura atmosferike ose diçka tjetër, po kemi shumë problem. Është mirë një informacion me na dhënë, nëse ke bisedue me KEDS-in. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Para se të filloj të flas, dua t'i lus përkthyesit që të kenë kujdes, që të mos hyjmë në mosmarrëveshje si pak kohë më parë. Zonja kryesuese, së pari, mos fusni fjalë që nuk i thashë. Ju ndoshta keni kërkesën time para jush. Kërkova të shihja ato pesë automjete të blera në 2021 dhe 2022. Zonja kryesuese, nuk ju kam kërkuar të parakaloni dhe të traumatizoni njerëzit me sirena këtu. Nuk bëhet kështu, lëreni në nderin tuaj. Sepse ju pëlqen të reklamoni veten, por kur më në fund të kuptoni se reklama po shkon në drejtimin e gabuar, atëherë patatën e nxehtë do t'ia hedhim dikujt tjetër. Unë vetë si kryetar i kuvendit, si personi i parë i kësaj komune, autoriteti më i lartë, nja dy herë kam kërkuar nga kryetari i komunës dhe drejtori i shëndetësisë që t'i shoh ato 5 vetura. Blerë me paratë e qytetarëve të komunës sonë. Vetë drejtori në raportin e tij ka shkruar se ka blerë pesë automjete në periudhën 2021 dhe 2022. Në këtë foltore erdhi Behar Brenoli, i cili tha se ka një automjet që po fiket. A duhet t'i luaj videot këtu tani, zonja kryesuese? Ju ishit të gjithë të pranishëm atje. Kjo që po bëni sot këtu është turp i pastër për institucionet e komunës së Dragashit. Traumatizimi i banorëve të kësaj komune. Nëna ime vetëm po më dërgon një mesazh, duke më treguar se çfarë ka ndodhur në Dragash. Kush e leshoi sirenat. Pushteti ekzekutivë dëshiron të reklamojë veten. Unë kërkova t'i shoh fizikisht ato vetura, dua të shoh dokumentacionin dhe të shoh dokumentacionin e tenderit siç janë blerë. Pesë vetura, nuk po flasim për 20 apo 30 vetura, e di që kjo komunë e Dragashit ka vetura, dua t'i shoh ato pesë vetura të blera në periudhën e vitit 2021 dhe atë të vitit 2022 fizikisht. Si duken, dua të di pse është blerë një automjet me defekt, ku e kam pranuar zotin Behar në këtë podium. Ju të gjithë keni qenë këtu në këtë sallë. A duhet t'ju pyes individualisht? Vete erdhi këtu dhe tha se automjeti po fiket. Por nuk është problem kur shkon me pacientin në Prizren, është problem kur shkon lart. Dua të shoh procesverbalin e komisionit që i ka marrë ato automjete dhe më intereson konkretisht ai Citroën që është sjellë këtu me defekt. Kush e ka marrë atë automjet, pse e kanë marrë dhe pse nuk i është kthyer furnitorit. Sepse kur blejmë celular, nëse është me defekt, e kthejmë, e lëre më një ambulancë. Kjo është ajo që ju kërkova, zonja Presidente, mos i formuloni mendimet e mia. E keni të shkruar në letër, nuk kam kërkuar që të vendosen mjetet e urgjencës. Imagjinoni nesër që dikush të kërkojë të shikojë automjetet e policisë ose zjarrfikësve. Çfarë do të ndodhte në bashki, në shtet. Fakti që ju tani po traumatizoni popullin dhe në të njëjtën kohë doni të ma hidhni fajin tek unë, unë ende insistoj, edhe nëse komisioni nuk është formuar. Unë do të gjej raste të tjera për të parë ato pesë automjete, për të parë të dhënat se si janë blerë dhe kush i ka marrë ato automjete, ju po bëni cirk nga kjo këtu për asgjë. Unë dua t'i shoh ato automjete dhe jam i interesuar për atë Citroën. Dua të di se kush e ka marrë mjetin me defekt, kush e ka blerë me paratë e qytetarëve të kësaj komune. Nuk më interesojnë automjetet e nëpunësve civilë, kujdesem për shëndetin e qytetarëve tanë. Kërkoj që të shqyrtojmë situatën dhe të kontrollojmë automjetet. Është turp, ju emëruat drejtor një mësues që

kujdeset më shumë për kanalizimet, lojërat e fatit dhe stadiumet se sa për shëndetin, dhe ju doni të tregoni veten si diçka të madhe, me një paradë trembni njerëzit që kanë mbetur në Dragash, madje edhe nëse. ata ikin, do të shpëtojnë veten.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, z.Sejdilar! Ti nuk e ke bërë kërkesën për defile, ti e ke bërë kërkesën a funksionojnë ambulancat e QKMF-së. Qysh e bëj unë, unë e di atje. A bëj defile a çka bëj. Por, për hir të qytetarit, që me e mbyllë një herë e përgjithmonë, unë e kam bërë atë defile. Ti nuk mundesh mu me më tregue a bëj defile, a ju marr komplet Asamblenë e ju çoj atje, unë këtu vendosi.

Artan Loshaj: Kryesuese, u bo pak e tepërt, unë po kam qef të përmbahemi njëri me tjetrin këtu. Problemi im ishte që – nuk deshta shumë me u kyç – për arsye se vij nga sektori në Urgjencë, unë disa herë kam bërë ankesa e kërkesa, mu nuk po më pëlqen me bo – qysh tha drejtori – defile para Komunës. Në qoftë se duhet edhe në qoftë se ti e ke vendos me e e bo – nuk e di Nedžmidini çfarë kërkesë ka bo – në qoftë se e ke vendos ti edhe në qoftë se pajtohen krejt grupet parlamentare, edhe jemi shumica për me e bo këtë, kishte qenë mirë - vendi ku po doni me e bo ju është i papërshtatshëm për qytetarët, para Komunës – e kemi Parkingun e QKMF-së, edhe përpara këtu, e kemi edhe mbrapa ku nuk shihen qytetarët. Janë mediat, le të vijnë aty mediat edhe le të bëhet kjo. Para Komunës është sfilatë – për mu si asambleist, nuk po due me diskutue ma tutje – është politike. Unë po të them që kam qef, si punëtor, të ketë oksigjen, të ketë gaza, të punon kerri, të punon alarmi, të punojnë dritat, të kemi goma rezervë, çdo ditë t'i kemi këto, se unë jam ai i pari që takohem me qytetarin. Ama, para Komunës mu nuk po më pëlqen, si asambleist, para Komunës. Thashë edhe një herë, i kemi dy parkingje të QKMF-së, vjen drejtori, vjen motra kryesore, vjen Drejtorati, kryetari, ju kush vjen, edhe vijnë mediat. A, para Komunës, është vend i papërshtatshëm, se e bllokojmë edhe komunikacionin.

Bexhet Xheladini: Të nderuar asambleistë, u akuzova që në seancën e kaluar unë nuk kam ndejt në mbledhje. Unë në seancën e kaluar i kam dëgjue të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e juaja, në fund kam dalë i jam përgjigj të gjitha pyetjeve, edhe normal, në debatet parlamentare shkohet kështu. Bëhen pyetje, atij që i bëhen pyetje, del e jep përgjigje, edhe kur të përfundoje ai s'ka nevojë më. Ju e keni shfrytëzue rastin, keni dalë e keni bo zhurmë, e keni keqpërdorë pozitën e juaj si asambleistë, normal, për çështje politike ka qenë ajo, jo ma shumë. Nuk e di, masi kam dalë unë, prapë u zhvillue një debat edhe janë bë pyetje, jam akuzue unë pse kam shkue. Unë përgjegjësinë time si kryetar e kam krye atë ditë, i jam përgjigj të gjitha pyetjeve që i keni bo. Në këtë Asamble, është bërë shumë zhurmë për automjetet, edhe për shëndetësinë. Nuk është fjala për shëndetësinë, por bëhet fjalë pse dikush s'po e duron edhe fizikisht drejtorin. Nuk është problemi që ka problem me shëndetësinë. Shëndetësinë e kemi gjet në gjendje katastrofale kur kemi ardhë. Sot shëndetësia, sin a aspektin organizativ, si në aspektin e pastërtisë, si në aspektin e investimeve, si në aspektin e profesionalizmit, është në gjendje jashtëzakonisht të mirë. Automjetet, kurrë nuk kanë qenë në gjendje më të mirë se sot. Janë të pajisura me të gjitha pajisjet që duhet me i pas një automjet i ndihmës së shpejtë. Në momentin kur, ata të cilët kanë bërë zhurmë, propagandë, kanë gënjyer qe një vit, kur e kanë pa që automjetet janë të gjitha në gjendje të rregullt, tash thojnë jo, s'kemi nevojë me i pa. Mu Nedžmidin Sejdlilar më ka çue email, sikurse edhe kryesueses, ka kërkuë decidivisht, due me i pa unë edhe asambleistët automjetet me sy. E kam emailin në telefon, edhe këtu ke thënë. Gjithashtu, ke thënë, më ke pyet mu si kryesues i Komunës, a kam të drejtë të marr pjesë në Komitete. Ke të drejtë me marrë pjesë në komitete, si çdo qytetarë tjetër, me qenë dëgjues, po jo me votue edhe me debatue. Kështu që, mundesh me e shfrytëzue këtë të drejtë sa herë të duash, se ashtu-kështu ti ke kohë, bredhesh rrugëve ditë e natë, ke kohë me ndejt edhe në komitete, edhe me fjet bile në komitete nëse ka nevojë. PDK-ja, në mes dy seancava që janë mbajt, i ka bo disa reagime. Reagimi i parë ka qenë për vizitën e disa komunave të Republikës së Serbisë në

Kosovë, edhe kanë kërkuar nga unë sqarim, pse i kam prit ata qytetarë. Siç e dini, këtë iniciativë e keni nis ju, më 2013-tën, edhe një delegacion i lartë i juaji, i qeverisë juaj, keni shkue i keni vizitue ato komuna. Ata kanë ardhë tash, na kanë kthye vizitën neve. Unë s'po them që keni bo gabim, është shumë mirë sepse këto vizita i ndihmojnë lehtësimit të dialogut që ka Kosova me Serbinë, edhe janë të organizuara nga ana e Kosovës nga Shoqata "Nëna Terezë", ndërsa nga ana e Serbisë është nga një OJQ demokratike të cilët e pranojnë Republikën e Kosovës. Ata kanë qenë këtu, janë mahnit me të drejtat që i kanë komuniteti joshumicë, edhe kanë ardhë me një bindje që nëse vijnë në Kosovë më nuk kthehen të gjallë. Ata janë ndarë shumë të kënaqur me këtë vizitë, edhe nëse doni unë i kam edhe emrat kush ka qenë në 2013-të prej qeverisë së kalume i ka vizitue ato komuna, ndaj i kam edhe me iniciale, kam edhe fotografi, po unë nuk po them që keni bo keq. Keni bo mirë, është mirë me u afrue, është mirë me e vazhduar dialogun, është mirë me u marrë vesh edhe kjo nuk është gabim. Mirëpo, ju më keni akuzue mu, keni harrue që këtë iniciativë e keni nis ju. Edhe ata kanë ardhë na kanë kthye vizitën ju që ia keni bo. Edhe kjo iniciativë financohet nga mjetet e BE-së, ata që kanë qenë këtu ne nuk kemi harxhue asnjë euro për vizitën e tyre, ata kanë ardhë me mjetet e veta dhe me mjetet e BE-së. Gjithashtu, sa i përket ngordhjes së disa peshqive në Liqenin e Breznes, prapë e keni bërë një reagim, por po më vjen keq që keni përdorur një fjalor të rrugëve, e keni quajtur kryetarin supermen. Nuk është mirë, ju jeni parti serioze, ju bën me rague, por jo me përdorur fjalor të papërshtatshëm i cili nuk iu përket juve. Unë çdo respekt për PDK-në kam, po jo ama me njerëzit të cilët jua shkruajnë këto statuset edhe përdorin fjalor të rrugëve. Ngordhja e atyre peshqive ka ndodhë më datën 13 maj, ndërsa personat e kanë qit në një faqe të fshatit Brezne më datën 16 maj. Më 17 maj, unë me kryetarin dhe me një drejtor kam shkue e kam vizitue Liqenin e Breznes, dhe në statusin tonë, në njoftimin e Komunës kemi thënë që ne nuk kemi vërejt asnjë peshk të ngordhur në sipërfaqen e Liqenit. Nuk kemi thënë që nuk është e vërtetë, nuk kemi thënë që nuk kanë ngordhë ata peshqi, por kemi thënë nuk kemi vërejt. Po të kishim vërejt, do t'i njoftonim organet. Unë e kam ditë pse ka ndodhë ajo, kam qenë në Brezne bashkë me nënkryetarin, jam takue me kryesinë e fshatit, edhe i kemi sqarue, ka qenë fjala disa qytetarë të Bresanës i kanë çue 116 peshqi, i kanë qit në Liqenin e Breznes, 16 prej tyre kanë ngordhë dhe kjo ka qenë si pasojë e saj. Kam edhe video edhe dëshmi, edhe deklarata të këtyre qytetarëve. Gjithashtu, në një reagim tjetër, ju prapë e keni kritikue shumë shëndetësinë. Unë siç thashë edhe në fillim, ne kemi bërë të pamundurën, kemi investue afër një milion euro në shëndetësi, edhe shëndetësia sot është në një gjendje shumë normale. Këtë nuk po e them unë, por po e thojnë qytetarët të cilët po shkojnë me marrë shërbime. Janë të kënaqur edhe me shërbimet, edhe me stafin që ofron shërbime, edhe me mjekët. E kemi një problem i cili nuk po varet prej nesh. Janë shërbimet e Laboratorit, të cilat për shkak të monopolit e cila e ka një firmë, një kompani, nuk po mund të pajisemi me reagensa. Edhe këtë do ta zgjidhim, ndërsa sa i përket shërbimeve tjera, të gjitha janë në nivelin më të mirë të mundshëm. Do t'i përgjigjem edhe për çështjen e rrymës, edhe pse nuk është kompetencë e Komunës. Unë kam pas edhe reagime, por edhe disa biseda telefonike me përfaqësuesit e KEDS-it. Ata nuk po mujn me e gjet momentalisht ku është problemi, është njëfarë lloj lidhje e shkurtë e cila kur po priset koha, po ndërprehet edhe rryma. Për stadionin, unë edhe dje ta kam dhënë përgjigjen edhe sot po ta them, ne e kemi bërë një marrëveshje me FFK-në, ne Komuna do t'i kryejmë një pjesë të punimeve, një pjesë Federata. Pjesën të cilën e kemi marrë përsipër me e krye Komuna, do të përfundojë tash brenda 10 dite. Fusha e stadionit do të përfundojë tërësisht, sipas projekteve dhe sipas standardeve që i parasheh UEFA. Edhe sipas kualitetit të barit, ai bar nuk është kancerogjen, ai bar do t'i rezistojë të gjitha kushteve atmosferike të cilat i ka Komuna jonë, është bar më special sesa që e kanë komunat tjera. Ndërsa, sa i përket rrethojës edhe zhveshtores, e ka për obligim FFK-ja, tash do ta shpallë tenderin edhe do të fillojnë punimet, do t'i përgatite. Sot,

Sabahat Hasani është në takim me Federatën edhe kanë me u marrë vesh kur me ia fillue punimet, ndërtimit të rrethojës, të zhveshtores edhe tribinave. Sa i përket stadionit të Blaçit, ne edhe stadionin e Blaçit do ta përfundojnë, ashtu siç jemi zotue. Ka vonesa, por në mandatin tim stadionin e Blaçit do ta kryejmë. Edhe atëherë kam thënë në mandatin tim. Sa i përket shkollës profesionale, unë sapo e kam marrë detyrën, kam shkue e kam vizitue atë shkollë dhe kam bërë përpjekje që të aktivizohet ajo shkollë. Aty janë bërë investime jashtëzakonisht të mëdha, ajo duhet të shfrytëzohet. Në kohën kur është planifikue ajo, ka pas shumë nxënës, edhe ndoshta ka qenë investim i qëlluar, po tash po del që ka qenë i planifikuar jo mirë, gabim, sepse është dashtë ajo shkollë të ndërtohet diku tjetër. Ka rezistencë prej bizneseve, qytetarëve, që të mos bëhet zhvendosja e Gjimnazit atje, për arsye se mund t'i dëmtojmë ne këtu bizneset që janë në Dragash. Kështu që ne, për momentin jemi të orientuar që atë shkollë ta shfrytëzojmë për çështje të tjera. Unë nuk muj të jap përgjigje për mjetet të cilat i ka shpenzuar qeveria e kaluar. Ti dje vetë thajë që afër 200 mijë euro i ka ndarë qeveria e kaluar, i ka shpenzuar. Unë nuk kam përgjegjësi çka kanë bo ata, unë kam përgjegjësi prej momentit që e kam marrë pushtetin si kryetar. Edhe, unë të kam thënë kështu, kur të doni bëne një komision, jo vetëm për stadionin, për çdo projekt, unë jam më shumë se ju i interesuar në qeverinë time – jo të juajën që e keni pas – nuk due me pas hajna. Unë jam i interesuar me bo komisione, edhe nëse ai komision vlerëson që ndonjë person, drejtor, nga Qeveria ime, që e konstaton ai që e ka bo një ...unë atë ditë e shkarkoj. Për çka kanë bë qeveritë e kalume, unë kam thënë nuk do të kqyri mbrapa, do të kqyri veç përpara. Tash, a ka bo qeveria e kalume lëshime a s'ka bo, e di populli, e dinë të gjithë. Ne duhet të ecim përpara. Unë përgjigjem për mjetet të cilat i shpenzojmë na, prej momentit kur una jam zgjedhë kryetar. Për automjetet, tash është ndërrue – kur është parë automjetet janë në gjendje superlative, çdo gjë e kanë, asgjë hiç nuk iu mungon – tash kërkojnë me e bo një Komision me shkue në vend të ngjarjes. Sot më nuk ka kohë, unë po ju them, në rendin e ditës në seancën e ardhshme, bashkë me kryesuesen, si pikë të rendit të ditës do të jetë formimi i Komisionit për me dalë me shkue në vendngjarje, me i shqyrtue të gjitha, prej 2001-tës, të gjitha automjetet që janë blerë deri sot. Edhe ju gjene edhe ndonjë ekspert, që është mekanik, që nuk është partiak, e qesim edhe atë në komision, edhe shumicën e komisionit le të bëjë opozita, edhe kryetarin e komisionit le ta bëjë opozita, edhe mundemi me shkue çdo gjë me e hulumtue. Por ju edhe Nedžmidin Sejdlari ka lyp sot me i pa, unë emailin e kam këtu, ka lyp me i pa me sy automjetet, edhe sot s'po pranon me i pa. Pse? Se ato janë në gjendje të rregullt, se nuk iu mungon kurgjo. Ore zotëri, aksidentalisht ti ke përfundue këtu si asambleist, ty të kanë zgjedhë tjerit, ti nuk e ke provue veten me dalë me vota të drejtpërdrejta me u zgjedhë. Unë po e përfundoj, ti ke kërku me ta mundësue ty me i pa automjetet. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlari: Më vjen keq që duhet të fitoj të drejtat e mia në këtë mënyrë. Ju lejoni që kryetari i komunesë të më ofendojë mua personalisht. Kështu Kryetari punon vazhdimisht kur nuk ka përgjigje për pyetjet vendimtare. Nga kjo foltore ai tha se shëndetësinë e ka gjetur në gjendje katastrofike, imagjironi sikur të drejtonit një komunë, shëndetësinë në gjendje katastrofike dhe t'ia zgjatni mandatin të njëjtit drejtor që e solli shëndetësinë në katastrofë. edhe 4 vite te tjera. Oferta ime është ende e vlefshme, nëse në emailin tim kam kërkuar të shoh automjetet sot, unë ofroj dorëheqjen time, por nëse jo, është koha që njëri prej jush të japë dorëheqjen.

Arijeta Skeraj: Edhe një herë publikisht po e them, kryetari nuk ka dalë për çështje të veta, është i ftuar nga Ambasadori i OSBE-së në cilësinë e kryetarit të Komunës. Për atë ju luta që pyetjet t'ia bëni sa është ai këtu. Gjithmonë e keni marrë këtë që kryetari po ik, edhe në seancën e kaluar kryetari i Komunës i ka dhënë të gjitha përgjigjet dhe pastaj ka dalë. Kështu që, para opinionit nuk është mirë këso kritika më bo!

Behar Brenoli: Se këto janë gënjeshtër të pastra, gënjeshtër më e mjera, e tregon vetë fakti dhe faktet flasin vetë. Më akuzuan mua si drejtor, ku janë ato automjete, dyshohej se ato automjete që ishin blerë nuk ekzistonin. Tani po ndryshon, jo se nuk janë blerë, por si janë blerë. Këto janë gënjeshtër të qarta. Do të flas vetëm me fakte, QKMF në Dragash, që nga themelimi e deri në vitin 2018, kur jam emëruar drejtor, ka pasur maksimumi 5 vetura. Gjatë mandatit tim si drejtor, nga viti 2018 e deri më sot janë blerë 5 autoambulanca dhe automjete të tjera. Viti 2018 WV Crafter 2015 viti. Që atëherë, ajo ka udhëtuar rreth 49,000 km. Në vitin 2021 kemi planifikuar të blejmë 2 vetura, një për Opole dhe një për Gora, pastaj ky kuvend ka ndarë mjete, janë blerë ato vetura, njëra për Krushevën dhe tjetra për Brodosanë të markës Boxer. Me disa mjete të mbetura, blemë një Citroen, i cili është blerë në mënyrë korrekte dhe funksionon si duhet edhe sot. Ai automjet ka udhëtuar nga Prizreni në Prishtinë për 24 minuta. Sa i përket akuzave se pse shkoj në hapje projektesh, unë jam politikan dhe nuk do të merrem vetëm me shëndetësinë, por me të gjitha fushat, çdo gjë që është në interes të qytetarëve tanë, do të merrem me të. Në veçanti, për stadiumin, përveç presidentit, drejtorisë së kulturës e të tjera, meritën më të madhe e ka pasur deputetja Duda Balje. Ajo është kryetare e partisë sime. Kështu që unë kam të drejtë të shkoj atje dhe të bëj foto.

Qamil Kolloni: I falënderoj delegatët, na quajtën të padijshëm. Ne edhe mund të jemi të padijshëm, se është normale i gjithëdijshëm është veç Zoti. Neve po na mëson Qeveria disa herë edhe po thotë shkoni mësoni edhe ata tjeërt me na çka po ju japim rekomandime. Sa i përket çështjes së buxhetit, Nedžmidin Sejdlari që dy herë e ngre çështjen në dy aspekte shumë të fuqishme. E para, kur fol për buxhetin, thotë kemi diskriminim. Mua po më vjen keq për delegatët e VV-së, PDK-së dhe LDK-së, që po e pranojnë këtë gjuhë diskriminuese qaq lehtë, kur duhet ta dinë edhe të jenë të informuar se vetëm në komunitetin goran 2 milionë e 400 mijë euro për vitin 2024 është rregullue rruga e cila është në mes dy fshatrave Rapçë-Kërçac-Pakishtë. 3,350,000 është rruga e cila nga buxheti i Komunës është ndarë për rrugën Zlipotok-Brod. 70 mijë euro janë investime direkte të kompanisë JICA vetëm për deponinë në Restelicë. I nderuari Nedžmidin Sejdlari, sa i përket gjuhës diskriminuese edhe moralizimit që po e bëjsh më kolegët tu delegatë të komunitetit, si në seancën tjetër, nuk ke të drejtë morale, për arsye se ne njihemi. Ne kemi qenë shumë afër dhe ne e dimë se ty kjo të vjen si rrjedhojë e zhvillimeve politike të partive të ndryshme këtu, dhe ti po moralizosh se po i shesin ata goranët. Po ne e dimë shumë mirë se ti ke qenë i Duda Baljes, dhe nuk është mirë të shesësh moral! Qe tash po të jap përgjigje edhe për shkollën profesionale. Ne e dimë që për atë shkollë e kemi mbyllë problemin, se kemi dhënë raportim këtu. Ajo shkollë sot e kësaj dite është e papranume teknikisht dhe realisht qe ky Kuvend i ka vu edhe emrin tjetër. Ke dashtë me e funksionalizue si shkollë profesionale. Në Komisionin për hapjen e drejtimeve profesionale kam qenë unë, Zenia edhe Uzair Hamza. Na kanë prit drejtori i Gjimnazit edhe i nderuari delegat Nexhat Selaj. Ne i kemi marrë instruksionet prej shkollës, se në kuadër të Gjimnazit të Përgjithshëm funksionojnë edhe drejtimet profesionale. Kemi kërkue cila mund të jetë kërkesa shtesë, si rrjedhojë e këtij Kuvendi që ju delegatët po harroni, që të mund ta rritim numrin e nxënësve. Me preferencë të drejtorit të Gjimnazit dhe kolektivit të cilët një ditë përpara e kanë mbledhjen – para se me shkue Komisioni – na kanë rekomandue që mund të shtohet vetëm Drejtimi i Infermierisë. Ai shtim është bërë në bazë të nxënësve. Realisht, ne i kemi bërë ato dhe kemi bërë pagesën si stimulim që nxënësit të kthehen dhe të shtohet numri i tyre. Ajo shkollë që kemi dashtë ta aktivizojmë, ka probleme juridike sot e kësaj dite. Çka është më e keqja, duhet ta dini që në Drejtoratin tim bjer edhe regjistrimi i pasurisë komunale mbi 1 mijë euro. Shkolla nuk është e regjistruar si inventar. Për këtë arsye duhet ta dini – se këtu i kam dhënë sqarimet çka lidhen me buxhetin, gjithë këto veprimet të cilat bëhen, investimet kapitale kanë një pikë që duhet të përfundojë. QPS-në nuk e keni regjistruar, shkolla

është pa pranue teknikisht se salla nuk ka përfundue sot e asaj dite. Kemi dhënë këtu sqarimin edhe kemi thënë që e kemi mbyllë këtë çështje, po ti tash po lypish sqarim, qeky është sqarimi, pa dashtë me e gjet fajtorin, kështu është situata. Prandaj, këto çështjet, kur ju moralizoni, i nderuar Nedžmidin, ta dini se për të drejtën e fjalës këtu me folë, dikush ka dhënë gjak dhe kujdeset për qata goranët tu që ti po i nënçmojsh. Këtu i takon LDK-së, PDK-së edhe VAKAT-it me e ngrit zërin, ti je hala i ri me e rujt demokracinë. Ky është tempulli i demokracisë që po të jepet ty me përdor gjuhë nacionaliste. Në emër të buxhetit po vidhet edhe po të shitet Gorja! Kush po ta blen Gorën tënde? Janë kolegët tut ë cilët janë në koalicion edhe bashkëqeverisin në mënyrën më të mirë të mundshme edhe të është dhënë e drejta me folë këtu edhe me e keqpërdor këtë foltore, se në seancën e kaluar e quajte qeveri diskriminuese. A janë 3 milionë euro që i janë dhënë komunitetit goran, diskriminuese? A pse t'i ka dhënë Qeveria e Kosovës, a nuk janë pare për komunitetin tënd, çka mendojsh ti? A pse VV-ja nuk del me të replikue për shkak se hajt se është LDK-ja në pushtet. Këta e dinë shumë mirë kush e ka barrën përsipër. Për 3 mijë euro të Rapçës mundohesh me e sulmue VAKAT-in. VAKAT-i është shumë më i madh se ti, se është pjesë përbërëse e shtetit të Kosovës, ka votue formimin e shtetit të Kosovës. Këtu është demokraci, por jo në këtë mënyrë të mundohesh me manipulue për një grusht vota, pse sot të ka dalë Duda Balje ty prej dorë. Ti ke qenë përparoll i saj. Ne të njohim mirë ty.

Arijeta Skeraj: Drejtor, nëse ke diçka specifike, pa i përmend emrat, ju kisha lut!

Qamil Kolloni: Edhe një pyetje profesionale. Sa i përket automjeteve, fati i mirë është që drafti i Auditorit të Jashtëm ka mbërri. Ai është mësuesi që na tregon se ku kemi bo shkelje. Pjesë e auditimit të jashtëm kanë qenë automjetet e QKMF-së, kanë qenë të regjistrueme edhe mjetet. Kanë ardhë ekselentë, kanë mbet vetëm edhe pjesët e vogla të shkollave të cilat nuk kanë qenë të inventarizume, nën 1 mijë euro vlerë. Sot e kemi pru në këtë gjendje, se nuk e ke pas Qendrën e Punësimit të regjistruar, ta kemi regjistruar; shkollat i ke pas pa regjistrueme, inventarin nëpër ambulanta e ke pas pa regjistrueme. Sot i kemi rekapitulue, të gjitha i kemi me një databazë, kemi hap dy depo, në shëndetësi edhe në arsim, për regjistrimin e mjeteve. Kemi ardhë në një situatë kur Raporti i Auditorit është më i miri i mundshëm, ai është që na noton neve, që i noton këta drejtorët që ju po i quani të padijshëm. Ju politikisht mund ta shfrytëzoni sa të doni këtë, se ne ju kemi dhënë të drejtë. Por, Nedžmidin Sejdlar, duhet ta dish edhe një send: se ka edhe një kod të etikës për përdorimin e fjalorit të urrejtjes. Në qoftë se përdorish si herën e kaluar, edhe në këtë seancë moralizosh me kolegët e tu dhe e përdorish këtë gjuhë ndarëse, të jesh i bindur se kam me ta ngrit çështjen, se nuk guxosh këso fjalori ti të përdorësh. Në fund të fundit, ti nuk je pjesë shtetformuese, ende nuk e ke dëshmue. Nuk mundesh ti delegatët ti fyesh dhe moralizosh!

Arijeta Skeraj: Drejtor, për herë të fundit ju kisha lut me e ndërpre fjalimin! Për replikë e ka fjalën një minutë Sejdlari! Iu përmend emri, Samidin! Të lutem, unë i di rregullat, prej atje asnjë fjalë! Të kisha lut, Sejdlari, një minutë, edhe një përgjigje e kam për Uran Halimin edhe e mbylli seancën!

Kryesuesje e Kuvendit
Arijeta Skeraj